

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 2
28.01.2019

NR. VENDIMI 2
01.02.2019

VENDIM
“PËR CAKTIM MASE SIGURIMI PASUROR”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtar: BIB NDRECA

Asistuar prej sekretares Alma Stafaj, sot më datë 01.02.2019, ora 12:30, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, kërkesën penale që i përket:

Kërkues:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, përfaqësuar nga prokurorët **Vladimir MARA dhe Dritan PRENÇI (në seancën e shpalljes së vendimit mori pjesë vetëm prokurorit Dritan Prençi).**

Objekt:

1.Caktimin e masës së sigurimit personal pasuror e sekuestros preventive për pasuritë e mëposhtme:

- **Bar-Restorant-Hotel “Resort Ador” me numër pasurie Nr.32/24, me sipërfaqe 3320 m2, me katër kate bar restorant, parking dhe hotel, me vendodhje në Rinas Tiranë, si dhe bllokimin e aseteve.**
- **Automjetin tip Audi me targa xx xxxxx.**

2.Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohen Oficerët e Policisë Gjyqësore Ilir Dorda dhe Atnan Shehu të cilët do të mbajnë procesverbalet përkatëse për dokumentimin e këtij veprimi.

Baza ligjore: Neni 274 275, 276, i Kodit të Procedurës Penale, dhe neni 36 i K.Penal.

Gjykata, në përfundim të gjykimit të zhvilluar, pas administrimit të provave, në prani të prokurorit (Dritan Prençi), i cili kërkoi sipas objektit, si dhe pasi shqyrtoi aktet dhe çështjen në tërësi, e analizoi kushtet për caktimin e masës së sigurimit pasuror, vendosjes së sekuestros preventive;

VËREN:

Gjykimi i kërkesës me objekt vendosje e sekuestros preventive u zhvillua në bazë aktesh, vetëm në prani të prokurorisë, pa u dëgjuar pala/ët tjetër/ra, duke i lënë vend kontradiktoritetit të palëve për t'u zhvilluar, në rast ushtrimi të ankimit, në shkallë të dytë. Kjo bazuar në qëllimin e parashikimit në nenin 274/1 të Kodit të Procedurës Penale, si përsa i përket rrezikut të vonesës në gjykimin e kërkesës (si element i sekuestros preventive) por edhe në përputhje me nenin 276/2 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon paraqitjen e ankimit nga personi i interesuar pas marrjes dijeni për sekuestron e vënë.

Pra ligjvënësi i ka parashikuar mbrojtjen efektive dhe aksesin në gjykatë palës, dhe kjo mund të bëhet edhe në Gjykatë pas ankimit të vendimit, për shkak të ngutshmërisë që paraqet kërkesa, dhe rrezikut të tjetërsimit të pasurive, sendeve pas vënies në dijeni të fillimit të gjykimit të një kërkesë të tillë. Po kështu duke qenë se personi nën hetim ishte me masë sigurimi arrest në burg në mungesë njoftimi i tij ose i përfaqësuesve të mundshëm do të sillte vonesa dhe për pasojë rrezikun e “humbjes”/tjetërsimit të pasurive dhe lënien e kësaj kërkesë pa objekt gjykimi.

A. Rregjistrimi i Procedimit.

I. Gjatë gjykimit rezultuan rrethanat e faktit si më poshtë:

i.Rregjistrimi i Procedimit Penal.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, rezultoi se Prokuroria Për Krime të Rënda, ka regjistruar procedimin penal nr.339 të vitit 2016, që bën fjalë për veprën penale të “Trafikimi i narkotikëve” parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal, ku me urdhërin e datës 05.03.2018, është bërë rregjistrimi i veprave penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” “Grupi i strukturuar kriminal”, dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 283, 333/a dhe 334 i K.Penal, duke e pasqyruar në rregjistrin e njoftimit të veprave penale përbri procedimit penal me nr.339 të vitit 2016.

Fillesat e vetë ky procedim i ka në një materjal ku Policia gjyqësore Pranë Komisarariatit të Policisë Kavajë, ka referuar materjalet hetimore në Prokurori, lidhur me disa shtetas që dyshohet se po kryejnë veprimtari të

kundraligjshme në drejtim të trafikimit të lëndëve narkotike. Nga aktet e para hetimore ka rezultuar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë, ka rregjistruar procedimin Penal Nr.552, të vitit 2016, procedim që lidhet me “Prodhim dhe shitje të narkotikëve” parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal, në ngarkim të shtetasve R.Sh., E.D., M.Xh. etj.

Gjatë hetimeve të procedimit në fjalë, i ndjekur edhe nga OPGJ të Seksionit të antitrafikimit të Narkotikëve, kanë rezultuar të dhëna se disa shtetas ndër ta edhe A.B., merreshin me trafikimin e sasive të madhe lëndësh narkotike nga Shqipëria në drejtim të shtetit Italian dhe vendeve të tjera Europiane. Gjithashtu fillimisht u identifikuan disa shtetas si bashkëpunëtor të A.B. të cilët ishin A.A., si dhe persona të cilët janë komunikues dhe lidhje e tyre identifikuar si shtetasit E.M., A.K., G.K., S.Gj. (Sh.), D.Ç. (D.), Sh.S., D.N., F.Ll., S.B., A.B. , si dhe personave të tjerë që hyjnë rishtazi në këtë veprimtari kriminale.

Gjatë hetimeve në vijim rezultoi se jo vetëm persona të caktuar bashkëpunonin me njëri tjetrin, por edhe grupe të ndryshme bashkëpunonin ndërmjet tyre, dhe si “urë lidhëse”, rezultuan persona të ndryshëm të dyshuar që merreshin me veprimtari kriminale madje jo vetëm në fushën e narkotikëve por edhe në një sërë veprash të tjera kriminale.

Në kushte të tilla Procedimi Penal nr.339, **në vijimësi të hetimeve u vendos (nga organi i akuzës me vendimin përkatës) ndarja e akteve në lidhje me disa subjekte duke e njohur si procedimin me nr.339 i vitit 2016, dhe 339/1 të vitit 2017, dhe me urdhërin e datës 05.03.2018, është bërë rregjistrimi i veprave penale të “Grupi i strukturuar kriminal”, dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a dhe 334 i K.Penal, duke e pasqyruar në rregjistrin e njoftimit të veprave penale përbri procedimit penal me nr.339/1 të vitit 2016. Si të dyshuar të këtij procedimi fillimisht ishin J.K./A. , i thirrur me disa pseudonime dhe emra, vëllai i tij Sh.A., si dhe një sërë bashkëpunëtorësh të tyre si D.Ll., A.Gj., K.Ll., H.S., dhe persona të tjerë si bashkëpunëtor të tyre permanent apo edhe që hyjnë tangent, rishtazi si të identifikuar ashtu edhe të pidentifikuar plotësisht.**

Linja e këtij grupi është dyshuar për trafikimin e lëndëve narkotike i kokainës nga vende të ndryshme të Europës madje edhe më gjërë, e trafikojnë dhe e shesin edhe në vend, por që merren edhe me trafikimin e Cannabis Sativa dhe kryerjen e një sërë veprash të tjera penale.

Ndërsa më vonë rezulton se procedimet sa më lartë të jenë bashkuar në një të vetëm, si dhe siç i citua tek pjesa hyrëse e këtij vendimi, duke u pranuar dhe aktet e ardhura nga Prokuroria Kukës.

II. Gjatë shqyrtimit të kërkesës rezultuan rrethanat e faktit sa më poshtë (ndër të tjera të pasqyruara në vendimet Nr.157, datë 21.10.2018 dhe Nr.11, datë 21.01.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë, si dhe aktet e administruara

në seancë gjyqësore):

Nga hetimet proaktive të kryera me metoda special të hetimit, si përgjimet telefonike, ambientale dhe vëzhgime, ka rezultuar se një grup personash, banorë në qytete të ndryshme të vendit, vepronin në formën e veçantë të bashkëpunimit në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, me qëllim kryerjen e veprave penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, trafikimit të narkotikëve, si dhe dispononin pasuri të paluajtshme, të cilat dyshohet se janë produkt i veprave penale. Gjithashtu gjatë hetimit ka rezultuar se pjesëtarë të këtij grupi kriminal kryenin edhe vepra penale të tjera, si korrupsioni në sektorë të publik të ndryshëm, si hipotekë, polici, bashki dhe në institucione të tjera të administratës shtetërore.

Nga veprimet hetimore të kryera është bërë e mundur dokumentimi i disa episodeve të sekuestrimit të lëndës narkotike dhe sendeve të tjera të kundraligjshme pjesëtarëve të këtij grupi të strukturuar kriminal, të cilët kanë vepruar në qytetet të ndryshme të Republikës së Shqipërisë dhe aktiviteti kriminal ka vazhduar në vijimësi.

Me datë 15.03.2017, Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore Gjirokastrë kanë arrestuar në flagrancë shtetasin P.V., (alias S.), i cili kishte në përdorim kartë identiteti greke me gjeneralitete të falsifikuara, ndërkohë që ky shtetas ishte person i shpallur në kërkim ndërkombëtar për veprat penale të shfrytëzimit të prostitucionit dhe të pjesëmarrjes në organizatë kriminale.

Arrestimi i këtij shtetasi është realizuar pas veprimeve me metoda speciale të hetimit, kryer nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Me datë 28.05.2017, nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore Lezhë është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasve N.F., F.M., G.N., pasi ka rezultuar se këto shtetas mbanin me vete në ambiente publike dhe në banesa të tyre sende të kundraligjshme, si radio komunikimi të ngjashme me ato të policisë, një sasi municioni, makineta, kompjutera që shërbejnë për lojra fati, automjet të blinduar, si dhe një sasi lënde narkotike të llojit cannabis sativa prej 236 gr.

Me datë 08.02.2017, Autoritetet Policore Italiane kanë ndaluar dhe sekuestruar një sasi prej 2 (dy) ton lëndë narkotike të llojit cannabis sativa, si dhe kanë arrestuar në flagrancë shtetasit shqiptar E.A. dhe A.Dh. . Gjithashtu nga Autoritetet Italiane është sekuestruar dhe mjeti lundrues me të cilin u trafikua lënda narkotike nga Shqipëria në Itali. Nga hetimet e kryera ka rezultuar se ky mjet lundrues është porositur në qytetin e Lezhës nga anëtarët e këtij grupi kriminal dhe më pas është transportuar në qytetin e Fierit ku dhe është ngarkuar lënda narkotike e sekuestruar në Itali. Gjatë hetimit të këtij episodi trafikimi rezulton se në këtë trafikim kanë qenë pjesëmarrës anëtarët e grupit kriminal, shtetasit A.B., Gj.N., E.M., P.S., S.S. dhe pjesëtarë të tjerë të këtij grupi kriminal. Nga hetimi rezulton se mjeti lundrues i sekuestruar në Itali me dy ton lëndë narkotike, ka udhëtuar në rrugë detare nga Fieri në Lezhë, ku dyshohej se do të ngarkohej me lëndën narkotike dhe do të nisej për në Itali.

Gjatë kohës që po planifikonin trafikimin e lëndës narkotike, disa ditë para realizimit të trafikimit, me datë 04.02.2017, shtetasit e mësipërm janë takuar me njëri-tjetrin në qytetin e Lezhës dhe kanë dyshuar se ndiqeshin nga policia (dyshohet se janë informuar). Po në këtë datë, këtë mjet lundrues e ka rimorkuar në karrel dhe e kanë tërhequr me automjetin foristradë, Range Rover, me targa xxxxxxxx dhe e kanë dërguar në rrugë tokësore nga Lezha në fshatin Qarr, Fier. Këto veprime të personave të dyshuar janë dokumentuar nga veprimet e përgjimeve telefonike dhe vëzhgimeve të kryera nga policia gjyqësore.

Gjithashtu, Autoritetet e Pulias, Itali, kanë sekuestruar sasinë prej 682 kg lëndë narkotike të llojit cannabis sativa si dhe mjetin lundrues me të cilin është transportuar kjo lëndë narkotike. Ka dyshime se kjo sasi lënde narkotike është trafikuar nga anëtarët e këtij grupi kriminal.

Siç u theksua edhe më sipër, duke qenë se në këtë veprimtari kriminale ishin të përfshirë një numër i madh personash, ata janë mbajtur në përgjim dhe janë kryer hetime me metoda speciale të parashikuara dhe si të tilla nga ligji procedurjal penal. Ndër të tjerë në këtë periudhë janë mbajtur në përgjim edhe numrat celular xxxxxxxxxxxx, në përdorim nga shtetasi me emrin V.N., si dhe numri xxxxxxxxxxxx, që rezultoi më vonë se përdorej nga shtetasi D.N. .

Personat në fjalë ka rezultuar të ishin në ndjekje të autoriteteve vendore Lezhë për vepra të tjera penale, ku gjatë kohës që po kërkohej për arrestimin e tyre, **me datë 28.05.2017,** nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore Lezhë, është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasve **N.F. , F.M., G.N. .** Kjo pasi ka rezultuar se këto shtetas mbanin me vete në ambiente publike dhe në banesa të tyre sende të kundraligjshme, **si radio komunikimi të ngjashme me ato të policisë, një sasi municioni, makineta, kompjutera që shërbejnë për lojra fati, automjet të blinduar,** si dhe një sasi lëndë narkotike të llojit **cannabis sativa prej 236 gr.** Personat në fjalë janë proceduar nga Prokuroria e Rrethit Lezhë për veprat penale të kryera prej tyre.

Ndërkohë që të dyshuarit e grupit kriminal merreshin me trafikimin e lëndëve narkotike, ata njëkohësisht bënin edhe shitjen dhe shpërndarjen e saj në “tregun” e brendshëm tek bashkëpunëtorët e tyre. Kështu A.A. ndër subjektet që vijonte në këtë drejtim rezultoi ti ketë “dhënë” lëndë narkotike kokainë disa personave ndër ta shtetasit **E.Gj. . Nga koordinimi i veprimeve të përgjimit telefonik me veprimet në terren të Policisë Gjyqësore, rezultoi se me datë 16.06.2018,** nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore Lezhë, është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasit **E.Gj. .** Kjo pasi ka rezultuar se gjatë kohës që ai po lëvizte me automjetin e tij **të markës BMË, ngjyrë blu, me targa xxxxxxxx,** nga qyteti i Laçit të Rrethit Kurbin, në drejtim të Lezhës, i është gjetur dhe më pas sekuestruar një sasi lënde narkotike të llojit kokainë në peshën prej **46.67 gr.**

Përveç trafikimit të lëndëve narkotike rastet e shitjes dhe shpërndarjes së saj në tregun e brendshëm nuk kanë qenë të pakta, por ka qenë një veprimtari e punës së tyre të përditshme. Kështu gjatë vepimeve hetimore ka

rezultuar të përfshiheshin subjekte apo grupe të ndryshme (dhe interlokutorët e tyre) në veprime të kundraligjshme. I përfshirë në këto veprime (por jo vetëm) rezulton i dyshuari **A.B.** dhe lidhjet e tij shoqërore ndër ta shtetasi **E.G.** . Me datë 11.06.2018, rezulton se **A.B. dhe E.G.** ti kenë shitur shtetasve **F.Xh.** dhe **A.H.** , një sasi lënde narkotike, e dyshuar e llojit kokainë. I dyshuari A.B. , pasi ka siguruar lëndën narkotike tek lidhjet e tij në Shkodër (me shumë mundësi nga pjestarë të S.B. por që kjo ngelet ta sqarojnë më tej organet hetimore në vijim), jua ka shitur më pas atë shtetasve F.Xh. dhe A.H. , të cilët ndodheshin në Shkodër për të marrë lëndën narkotike. Gjatë kontrollit, këtyre personave iu është gjendur dhe sekuestruar një **sasi prej 11.39 gr lëndë narkotike e llojit kokainë, si dhe 2.41 gr lëndë narkotike të llojit cannabis sativa.** Nga sa më sipër policia gjyqësore ka bërë arrestimin në flagrancë të shtetasve F.Xh. dhe A.H., si të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283 i K.Penal.

Me datë 22.06.2018, F.Xh. ka dërguar në Shkodër sipas porosisë së tij, të dyshuarin **L.B.** , ku ky i fundit ka takuar shtetasin **A.B.** (sipas porosisë së F.), dhe pasi ka marrë lëndën narkotike, është nisur në kthim për në Bulqizë me një mjet transporti furgon pasagjerësh. Policia Gjyqësore që po ndiqte rastin, në kordinim me Policinë Vendore Mat (me qëllim mos dëmtimin e hetimeve për krerët e grupit kriminal në lëmin e narkotikëve), kanë ushtruar kontroll personal ndaj të dyshuarit L.B. , në ambjentet e një lokali, ku ishte ndaluar për pushim (ai udhëtonte në aksin rrugor Burrel-Bulqizë me automjetin me targë xx xxx xx). Të dyshuarit i është gjetur dhe më pas sekuestruar një sasi lënde narkotike e dyshuar e llojit “kokainë” në sasinë **prej 22.75 gr.**

Me datë 16.06.2018, nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore Durrës kanë ushtruar kontroll tek banesa e shtetasit S.Gj. , ku janë gjetur dhe sekuestruar me cilësinë provës materiale, sasia prej 149 gr lëndë narkotike e llojit kokainë, një peshore elektronike, dy armë automatike, një armë pistoletë, një armë gjahu, një pistoletë sportive, një sasi municioni, dhe një automjet i blinduar.

Kapja dhe sekuestrimi i sendeve të kundraligjshme në këto dy episode të mësipërme është kryer si rezultat i përgjimeve telefonike dhe vëzhgimeve në terren të bëra në kuadër të hetimit të këtij procedimi penal.

Gjatë hetimeve të deritanishme, ka rezultuar se një ndër personat e dyshuar që merret me veprimtari kriminale kryesisht atë të shitjes, transportimit dhe tregtimit të lëndëve narkotike (përfshirë dhe dyshimet për trafikim vepra këto të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal) është i dyshuari **A. alias P.K.** . Personi në fjalë pasi e siguron lëndën narkotike kryesisht atë të llojit kokainë tek lidhjet e tij në Shijak, (ku rezulton se furnitori i parë i tij është H.S. dhe lidhjet e grupit të tij kriminal) e shet më pas atë tek personat e tjerë (qoftë tek blerës me qëllim konsumimi apo tek blerës me qëllim tregtimitin e saj në qytete të ndryshme).

Përveç se në përgjimet telefonike, i dyshuari **A. alias P.K.** është mbajtur nën vëzhgim, survejim dhe përgjim ambjental dhe metodave të

tjera procedurjale duke përfutuar të dhëna që bëjnë me dije lidhur me veprimtarinë kriminale të tij dhe bashkëpunëtorëve të tij. Kështu ka rezultuar se me **datë 24.06.2018**, Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Komisariatit të Policisë Sarandë, kanë bërë arrestimin në flagrancë të shtetasit **A.Q** , i cili po lëvizte si pasagjer tek automjeti me targa xxxxxxxx me drejtues shtetasin S.A. .

Gjatë kontrollit shtetasit A.Q. , i është gjetur dhe sekuestruar një sasi lënde narkotike e llojit kokainë. Kapja dhe sekuestrimi i kësaj lënde narkotike është bërë si rezultat i kryerjes së veprimit procedural ndër të tjerë atë të të vëzhgimit të personit të dyshuar, shtetasit A.K. , pranë banesës së të cilit ishte parkuar, dhe u largua më pas automjeti me targë **xxxxxxxx**.

Personi A.S.Q. , ka patur në përdorim numrat e telefoni xxxxxxxxxxxxxx dhe xxxxxxxxxxxxxx, dhe rezulton se ditën e ngjarjes ka patur komunikime me A. alias P.K. . Nga trupa e Forcave operacionale me datë 23.06.2018 dhe 24.06.2018 (ku janë mbajtur raport vëzhgimet përkatëse), janë kryer vëzhgime në Sarandë dhe Delvinë, për lëvizjet e A.K. .

Nga vëzhgimet e bëra ka rezultuar se makina me targa **xxxxxxxx**, ishte e parkuar afër shtëpisë së A. . Pas verifikimeve, u ndalua dhe u bë kontrolli i automjetit në fjalë, ku personit sa më lartë ju sekuestrua një sasi e vogël lënde narkotike e dyshuar si e llojit Kokainë, për të cilën ka të dhëna se e ka siguruar tek i dyshuari A. alias P.K. .

Gjithashtu me datë **08.07.2018**, nga vëzhgimi i personit të dyshuar **A.K.** alias P.K. , i cili po lëvizte me mjetin e tij tip Volvo, me targa xx xxxxx nga Tirana në Gjirokastrë, me pasagjer shtetasin **B.S.** , gjatë kontrollit këtij të fundit i është gjetur një sasi lënde narkotike e llojit kokainë.

Me datë **08.07.2018**, ka rezultuar se i dyshuari **P.J.K.** , (posedues i disa numrave celular nda ta i numrit **xxxxxxxxxxxx**) **së bashku me B.M.S.** , (posedues i numrit celular **xxxxxxxxxxxx**) dhe **M.Z.S.** , kanë ardhur në Tiranë, ku janë takuar me **H.S. tek Hotel “Real Park” në autostradën Durrës – Tiranë, në Kashar.**

I dyshuari A. rezulton se ka qëndruar disa orë në ambjentet e këtij hoteli së bashku me personat sa më sipër, ku në një moment kanë vijuar takimin e tyre pas hotelit dhe më pas janë nisur për në Sarandë.

Më pas në kthim nga Tirana është organizuar kontrolli dhe sekuestruar një sasi e vogël narkotike e dyshuar e llojit kokainë.

Gjatë hetimeve (si në raport vëzhgimet, përgjimet telefonike etj), rezulton se A.K. , lëndën narkotike e shet tek subjektet në vende të ndryshme (si në automjet, në lokale), por që ai ka aktivizuar edhe djalin e tij të quajtur **A.** , i cili ju jep personave lëndë narkotike sipas porosisë së babait të tij.

Si subjekt që bëhet pjestar i grupit e personave që merreshin me veprimtarinë në fushën e narkotikëve ndër të tjera rezulton edhe i dyshuari **K.D.** dhe lidhjet e tij. Veprimtaria e tij nis herët dhe duke qenë se kishte të dhëna për përfshirjen e tij në këtë veprimtari, ndaj tij dhe

lidhjeve shoqërore që kishte dyshime për përfshirje në trafikimin e lëndëve narkotike, u kryen hetime. Kështu me datë **15.09.2018**, Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Sarandë, kanë arrestuar në flagrancë shtetasit **A.B.** dhe **K.D.** , pasi po tentonin të trafikonin për në Greqi, nëpërmjet kufirit të gjelbërt një sasi lënde narkotike të lloji cannabis sativa **prej 33.4 kg. Duke patur të dhëna për përfshirjen e tij në veprimtari kriminale të trafikimit të lëndëve narkotike ai është mbajtur në përgjim (si telefonik ashtu edhe vazhdim dhe përgjim ambjental).**

Personi në fjalë ndër të tjerë rezulton të ketë përdorur numrin celular **xxxxxxxxxxxxxxxxxx**, **i cili është mbajtur në përgjim sëbashku me të dyshuarit e tjerë.**

Më datë 02.10.2018, Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, kanë arrestuar në flagrancë shtetasin D.D. . Kjo pasi gjatë kohës që po udhëtonte me automjetin tip Renault, me targa xxxxxxxx, në drejtim nga Fieri në Lushnje(në vendin e quajtur “Rotontoja e Savrës” Lushnje), me pasagjer shtetasin M.Gj. , nga policia është ushtruar kontroll i personave dhe automjetit, ku është sekuestruar një sasi lënde narkotike e llojit kokainë në masën prej 102.95 gr.

Nga koordinimi në kohë reale i veprimeve të OPGJ që merren me përgjimet, me ata të Forcave Operacionale në terren, është bërë i mundur arrestimi sa më sipër duke sekuestruar edhe lëndën narkotike.

Në kuadër të këtij Procedimi kanë rezultuar të përfshirë një sërë personash që kryejn veprimtari të ndryshme kriminale, ku në jo pak raste janë të përfshirë edhe zyrtarë shtetëror. Një ndër personat që ka komunikime të shumta edhe me të dyshuarit e përfshirë në veprimtarinë e lëndëve narkotike është A.Gj. , që rezulton punonjës policie në pikat kufitare.

Personi në fjalë kundrejt veprimeve në kundërshtim me ligjin bën kalimin e personave në kufi, të cilët mund të rezultojnë me probleme, precedent kriminal me apo pa të drejtë për të hyrë apo dalur në territorin e Republikës së Shqipërisë. Pra ai konsumon ndër të tjera veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës’ dhe “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit’, qoftë në rastet kur ai është në detyrë gjatë orarit të punës apo edhe në kohën kur nuk është në orar të punës, duke telefonuar kolegët e tij të cilët nuk janë identifikuar plotësisht deri më tani. Personi në fjalë ka kryer disa herë veprime të kundraligjshme sa më lartë.

Të dhënat e përfuara nga aktet bashkangjitur kërkesës për caktimin e masës së sigurimit tregojnë se disa persona janë “urë” lidhëse e grupeve të ndryshme kriminale siç është ndër ta personi i dyshuar H.S. (i cili bashkëpunon jo vetëm me persona të ndryshëm por është edhe bashkëpunëtor i grupeve të ndryshme kriminale).

I dyshuari në fjalë rezulton me aktivitet të shtuar dhe të hershëm në lëmin e narkotikëve (por jo vetëm). Ai kordinon veprimtarinë e personave që trafikojnë dhe ndër të tjerë edhe që shesin dhe blejnë lëndë narkotike. Lidhjet e tij shoqërore dhe bashkëpunëtor të tyre ndër të tjerë rezultojnë (si të identifikuar, por që rezultojnë edhe shumë persona akoma të

paidentifikuar plotësisht) M.A. , i njohur edhe me emrin M. , alias K.P. , mbajtës i numrave celular **XXXXXXXXXX** dhe **XXXXXXXXXXXXXX**, **E.D. , P. alias A.K. (i cili furnizohet vazhdimisht tek H.S. , ndër të tjera edhe në rastin e gjetjes dhe sekuestrimit të lëndës narkotike e dyshuar si kokainë me datë 08.07.2018, i cili sipas të dhënave në dosje rezulton të ketë patur në përdorim numrat e telefonit XXXXXXXXXXXX, XXXXXXXXXXXXXXXX, XXXXXXXXXXXXXXXX, XXXXXXXXXXXXXXXX, XXXXXXXXXXXXXXXX).**

I dyshuari H.S. dhe bashkëpunëtorët e tjerë në veprimtarinë e tyre rezultojnë që përveç se veprime të kundraligjshme në lidhje me narkotikët (si në trafikim ashtu në shitje, transportim tregtim etj), rezultojnë se kanë patur përfitime të mëdha të cilat i kanë investuar në pasuri të ndryshme.

Gjithashtu në kuadër të këtij procedimi duke qenë se kanë rezultuar të dhëna të shumta se personat e dyshuar, nga aktiviteti i kundraligjshëm kanë nxjerrë të ardhura të shumta të cilat i kanë investuar në pasuri të ndryshme, prokuroria ju ka atribuar atyre edhe veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 të K.Penal. Në kuadër të këtyre veprimeve rezultojnë edhe të dhënat e përfutuara nga aktet në dosje ndër të tjera të përfutuara nga përgjimet telefonike (por edhe të konfirmuara me raportet përkatëse të vëzhgimeve.

Kështu me datë 05.04.2018, i dyshuari **H.S.** , përdorues i numrit xxx xx xx xxx komunikon me përdorues i numrit xxxxxxxxxxxxxx (dyshohet babai i tij pasi kjo rezulton nga përmbajtja e përgjimit), sipas të cilit; **“He babe.../Na foli i herë ksaji.../Po bre ma kalo.../Alo mirmëngjesi H./Mirmengjesi...Nga T.B, jam E., ka ardhë babi ktu dhe do te baji ni veprim thotë do të hapi llogari të arkëtojë 500 mije Euro sepse thote do bëji pagesat e firmave, tani ma sqaro ni çikë si domethan për qa do hapet llogaria.../Sepse do paguhet firma pra.../ Do paguhet firma po me firmën ke lidh ndonjë kontratë paraprake.../Jo, jo, nuk kam asi lloji kontrate/Po sa do jetë vlera e investimit sepse nuk lejohet që domethënë të bëhen pagesa nga një llogari individuale tek firma, nëse nuk ka një dokument perkatës...”**.

Nga të dhënat e përfutuara deri më tani nuk rezultojnë që H.S. apo ndonjë i afërt i tij të ketë aktivitet tregtar, biznes të ligjshëm, dhe ka dyshime të arsyeshme të bazuara se këto transaksione dhe të ardhura vijnë nga aktiviteti i tij kriminal dhe i grupit të tij kriminal.

Përveç përgjimeve telefonike dhe vëzhgimeve, përgjimeve ambjentale, (etj), për të evidentuar veprimtarinë kriminale në respektim të dispozitave Procedurjale (është lejuar nga Prokurori dhe është miratuar me vendim Gjykate) është lejuar instalimi i paisjes audio & lokalizuese “PEAK AUTO”, me numër Nr.76002, në automjetin e **H.S.** , tip Volvo, me targa **“xx xxx xx**. Realizimi i instalimit të paisjes së përgjimit audio & lokalizuese “PEAK AUTO”, me numër Nr.76002, në automjetin tip Volvo, me targë “xx xxx xx”, u krye me datë 14.07.2018, ora 13:00 (sipas procesverbalit përkatës).

Sipas Procesverbaleve të transkriptimit të përgjimit ambjental datë 14.07.2018, ora: [17:22:42] Drejtuesi bisedon me një shtetas jashtë makinës.

Drejtuesi i mjetit: A më kuptove për çar të kam thonë apo jo?/Shtetasi: A për atë gjysën apo jo./Drejtuesi i mjetit: Po: **Me atë çmim që të**

thashë dje!/Drejtuesi i mjetit: Jo./Shtetasi : **S'ma le ma lir për zotin.**/Drejtuesi i mjetit : 32 e gjysë merre./Shtetasi : Ja ti them./Drejtuesi i mjetit : Ok a e di ç'do bosh?²/Shtetasi : Hë./Drejtuesi i mjetit : **Do ikish të bish 200 copë ose 300 nesër,ik merr 200 copë o po mi nis me atë çmim 33 tha ai?**/Shtetasi: 34 pra./Drejtuesi i mjetit : Jo 34 jo ja q.. motrën./Shtetasi: Për zotin aq të thashë unë ty./Drejtuesi i mjetit : Po jo o kot pa lidhje./Shtetasi: Për kokën time.../Drejtuesi i mjetit: A the një pikë ma shumë?²/Shtetasi : Po aq pra 34 ma ka lonë nuk shkon që të fitoj unë një 500 she./Drejtuesi i mjetit: Ti ma le mu me 32 radhën e patë./Shtetasi: Po e fitova 500./...../Drejtuesi i mjetit: Ja po ska o kot pa lidhje./Shtetasi: **Për kokën time,unë të thash sa të vijn gjonat unë kam porosit si rob i im ka porosit në mal ca gjona ishalla do jenë të mira do vijnë.**/Drejtuesi i mjetit : Ok kjo o pa lidhje./Shtetasi : E di i thashë....e di çar m'tha dje, për qef thashë se e dija që s'ashtu ai ...letshëm fare për zotin.Nga ishe?²/Drejtuesi i mjetit: **Mu teshi më kërkoi njeni një gjysëm.....i thashë jo.**/Shtetasi : A/Drejtuesi i mjetit: **Për një mujë e gjysëm kontrolle të rrepta.**/Shtetasi : Për zotin e madh me gjithë qejf./Drejtuesi i mjetit : **është ai, më kërkoi ne një tjetër 200 sot 300 nesër.**/Shtetasi : **Ashtu si i kena bo bashkë dy tri gjona shpejt e shpejt ene mu më ke neru se unë një 500 e kom fut në xhep bam bam....**

Nga hetimet rezulton se shtetasit **M.Z. (alias E., D.), E.Sh., A.S.** kanë kryer aktivitet kriminal në formën e mbajtjes, shpërndarjes, dhe shitjes (por dyshimet janë edhe për përfshirjen e tyre në trafikimit të lëndëve narkotike) në kuadër të grupit të strukturuar kriminal të drejtuar nga shtetasi H.S. . Aktiviteti kriminal i këtyre shtetasve shtrihet në qytetin e Tiranë, pasi nga përgjimet dhe vëzhgimet rezulton se këto persona shkëmbejnë dhe shpërndajnë lëndë narkotike në zona të ndryshme të qytetit Tiranë.

Gjithashtu rezulton se Armando Spiro, thirret në rrethin e ngushtë me emrin Tuku (më sipër në përgjimin ambjental të automjetit të H.S. rezultoi se Tuku udhëtonte me të në makinë, bënte pazare për lëndët narkotike, çmimin etj), dhe dyshohet se e mban A.A. edhe si shofer, çka tregon për lidhjet e ndërsjellta të bashkëpunëtorëve në këtë grup kriminal. Lëndën narkotike kryesisht të llojit kokainë ata e sigurojnë tek H.S. dhe bashkëpunëtorët e tij, por edhe tek vëllezërit A. .

Nga hetimet rezulton se shtetasi **B.K.** , me detyrë punonjës policie në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier në Sektorin Kundër narkotikëve ka ndihmuar anëtarët e grupit kriminal dhe konkretisht nëpërmjet shtetasit H.S. duke shfrytëzuar të dhënat dhe pozicionin e punës së tij.

Numri xxxxxxxxxxxx, me datë 16.07.2018, ora 18:58, (që e përdor herë pas here B. që dyshohet se është punonjës policie) flet me numrin xxxxxxxxxxxx, dhe i thotë: o h. jam aji ...Fierit se po të marre me ni telefon tjetri s,eshte telefoni im, ti kishe dhe 3 gjoba të tjera për dy vitet e fundit ti ke katër gjoba , dhe nuk pagun dot 60 mijë minimalen pagun 120 nga 150 që ishte ajo /po me të ardhe unë me të dhan 20 mijë lekshit me më dhën një numër ti mu /po erdhe aty më gjen mu /po a di me ardhë atje unë të ishim taku n,Fier me mirë/unë ta paguava faturën/mirë për dy tre ditë unë do vijë andej, po si me të kërkuar unë ty andeji/po ke policia

B. i kam emrin B., që punon ke droga thuaj, nga e hëna në të premtë aty jam unë. Ka të dhëna se personi në fjalë duke patur informacion përshkak të detyrës, mban të informuar për lëvizjet e organeve hetimore H.S. dhe anëtarët e tij të grupit.

Gjithashtu në kuadër të Procedimit sa më lartë, janë vënë në hetim dhe janë përfutur të dhëna lidhur me aktivitetin e kundraligjshëm në lëmin e narkotikëve si në trafikim ashtu edhe në prodhim, shitje dhe tregtim të tyre, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal shtetasit: **A.B. alias A. ,** vëllai i tij, **A.A.** si dhe lidhje e tyre, shtetasit **Gj.**

N. , D.N. etj, ku dyshimet kanë qenë në kuadër të trafikimit të lëndëve narkotike (si kokainë dhe heroinë) nga vende si Kolumbi, Peru, dhe e shpërndajnë në shtete si Holanda, Gjermania, Franca etj, ndërsa lëndën Cannabis Sativa e trafikojnë nga Shqipëria në drejtim të vendeve Europiane. Për këtë arsye personat sa më sipër janë vënë në përgjim telefonik, dhe me metoda të tjera speciale të hetimit si vëzhgim, survejim, përgjim ambjental etj.

Nga të dhënat e përfutuara gjatë hetimeve për lidhjet e tyre me veprimtarinë në lidhje me narkotikët, personat sa më sipër (por jo vetëm), kanë rezultuar të kryenin edhe një sërë veprash penale si fallsifikime, ndërhyrje tek zyrtarët, korrupsion etj. Nga provat e paraqitura së bashku me kërkesën rezulton se Gj.N. ka qenë i punësuar si zyrtar lokal ne Prefekturën Lezhë. Gjatë kësaj kohe (pas vitit 2013), ai ka krijuar lidhje si shoqërore ashtu edhe varësi hierarkike në punë me disa punonjës së zyrave në ZRVPP Lezhë. Por ai rezulton se këto lidhje i ka krijuar edhe me punonjës të ALUIZNIT, noter etj.

Personi në fjalë rezulton të ketë komunikuar me shumë persona të tjerë të administratës shtetërore kryesisht të ZRPP Lezhë, Kurbin, në Prefekturë, ALUIZNI, Noter etj, ku nga transkriptimi i përgjimeve (dhe një sërë provash të sekuestruara më pas) ka rezultuar të dhëna për përfshirjen e Gj.N. dhe disa personave të tjerë në fallsifikimin e dokumentacionit, ku në bashkëpunim me njëri tjetrin bëjnë tjetërsimin e pasurive nga shtetërore në private (kryesisht në emër të tyre apo të personave të tjerë duke përfituar në finale në mënyrë të pa rregullt pasurinë shtet me dokumenta të fallsifikuara).

Bashkëpunimi në këtë veprimtari kriminale (e gjitha kjo në kuadër të grupit të strukturuar kriminal) vijon që me përcaktimin e parcelës e cila është me pronësi shtet, gjetjen e personave të interesuar për tu paisur me tokë, fallsifikimin e dokumentave (që nga origjina e pronës deri tek çertifikata e pronësisë) dhe më pas në aktin final përfitimi në mënyrë të pa rregullt të këtyre sipërfaqeve të tokës, ku shpesh herë përfituesi final është vetë Gj.N. , lidhjet e tij shoqërore dhe familjarët e tij.

Nga provat rezulton se ndër të tjera personat kanë bërë ndërhyrje në dokumentacionin e disa pasurive të paluajtshme ndër to në pasuritë me numër 1018, 2513, 540, 4476, 131C indeksi etj.

Si bashkëpunëtor të të dyshuarit Gj.N. punonjës në zyrat vendore Lezhë, deri më tani ndër të tjerë rezultojnë shtetasit **E.S., B.C., B.N.(Shkodrani), L.Z.**. Ndërsa personat të cilët kanë përfituar sipërfaqe toke nëpërmjet dokumenteve të fallsifikuara dhe në kundërshtim me ligjin 7501 datë 19.07.1991, të identifikuar deri më tani rezultojnë shtetasit **K.Z.Ll., V.G. , Z.N., M.N., P.S. dhe V.N. .**

Gj.N. ka bërë të mundur të siguroj akte të marrjes së tokës në pronësi në emër të shtetasve K.Ll., V.G., Z.N., të cilat mbajnë data fiktive për periudhën e përpilimit dhe leshimit të dokumenteve dhe pasi kanë plotësuar praktikat përkatëse me dokumente të falsifikuara, me ndihmën e personave të tjerë punonjës në ZVRPP kanë arritur të regjistrojnë pasuri në sipërfaqe të konsiderueshme në emër të tyre dhe

personave të tjerë dhe më pas i kanë tjetërsuar, duke bërë shitje dhe blerje fiktive, pranë zyrave noteriale tek noterët, shtetasi **E. Gj.** dhe punonjësi i kësaj zyre shtetasi **Z. L.** etj.

Nga hetimet e kryera rezulton se ky grup i strukturuar kriminal i drejtuar nga shtetasi Gj.N. (alias Xh.) ka patur qëllim përvetësimin total të trojeve dhe pasurive të paluajtshme të shtrira në katër zona bregdetare të rrethit Lezhë: Ishulli Shëngjin, Ishulli Lezhë, Mali i Shëngjinit dhe Mali i Rencit. Duke qenë se këto zona rezultojnë në kadastrë me pak tokë bujqësore objekt të ligjit Nr. 7501, ky person me anëtarët e këtij grupi kanë vepruar me një mënyrë organizimi në formën e bashkëpunimit të grupit të strukturuar kriminal dhe kanë përfituar sasi të mëdha trojesh, të cilat jo vetëm që nuk janë tokë bujqësore por rezultojnë të jenë vijë bregdetare rërë, sipërfaqe lagunash, pothuajse pjesën e malit shkëmbor dhe gurorë të Shëngjinit apo Rencit, si dhe pyje.

Pas përfitimit të këtyre pronave anëtarët e këtij grupi kriminal kishin si qëllim përvetësimin e pasurive në favor të tyre duke përdorur emrat e individëve të komuniteteve rurale apo qytetit Lezhë, në emër të të cilëve i regjistronin fillimisht këto pasuri dhe më pas këto pasuri të përfituara në mënyrë të paligjshme kalonin përsëri tek anëtarët e grupit kriminal me anë të veprimeve noteriale fiktive që paraqiten si kontrata dhurimi apo shitje formale fiktive. Dhurimi jo logjik nga dhuruesit të këtyre pasurive të paligjshme tek anëtarët e grupit është pasqyra më e qartë për të provuar përvetësimin masiv të këtyre pronave shtetërore në mënyrë të paligjshme.

Përveç qëllimit të thjeshtë të përvetësimit, këto prona përdorshin edhe për të kryer shkëmbime me objekte të ndryshme të llojit apartamente banimi dhe duke qenë se këto pasuri të patundshme kishin një treg më të lartë shitje, shisnin më pas duke përvetësuar të ardhurat në vlera monetare kesh.

Në ndonjë rast, sasi jo të konsideruara të mëdha toke, subjekti Gj.N. i përdorte edhe për të bërë favore personave me status të lartë publik.

Nga sa më sipër rezulton se shtetasi **Gj.N. në bashkëpunim me familjar të tij, shtetasit Z.N., M.N., si dhe me shtetasit V.G., P.S., K.Ll., V.N., të cilët paraqiten si përfitues të pasurisë, si dhe me shtetasit E.S., B.C., L.P., L.Z., B.N. (Shkodrani), të cilët paraqiten si persona të cilët kanë qënë punonjës të ZVRPP Lezhë dhe kanë marrë pjesë në falsifikimin e dokumenteve, si dhe me shtetasit E.Gj., Z.L., noter dhe ndihmës i noterit E.Gj.**, kanë kryer disa vepra penale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, duke filluar që nga gjetja e numrave të parcelave, gjetja e personave që të mund të bënin transaksionet fiktive, falsifikim të dokumentave dhe akteve noteriale duke bërë kështu ndryshim e zërave të tokës shpërdorimin e saj, përpilimin e dokumenteve të falsifikuara, siç janë aktet e marrjes së tokës në pronësi dhe dokumente të tjera të cilat shërbejnë për regjistrimin e pasurive si dhe falsifikimin e akteve noteriale.

Nga hetimi rezulton se personat e mësipërm me veprimet e kundraligjshme për regjistrimin e pasurisë në kundërshtim me ligjin kanë kryer veprat penale “Falsifikimi i vulave, stampave ose i formulareve”, “Shpërdorimi i tokës, “Shpërdorimi i detyrës”, në

bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuara nenet 186, 190, 199, 248, 333/a dhe 334 të Kodit Penal.

Në funksion të hetimeve të procedimeve cituar si tek pjesa hyrëse e këtij vendimi, ka rezultuar se të dyshuarit që merren kryesisht me veprime të kundraligjshme lidhur me narkotikët, kryejnë edhe veprime të tjera në kundërshtim me ligjin si ndikimi i paligjshëm tek zyrtarët, në veprimtarinë e rregullt të tyre, me qëllim korruptimin veprim ky i kundraligjshëm dhe shoqërisht i rrezikshëm, të cilat i kryejnë në kuadrin e grupit të strukturuar kriminal. Megjithëse hetimet kishin nisur për veprat penale të trafikimit të narkotikëve(nga dhe për në Shqipëri) dhe shitjes dhe tregtimit të saj në „tregun e brendshëm“, hetimet dhe përgjimet treguan për kryerjen e veprave të ndryshme penale nga anëtarët e grupit, të cilët përfshijnë edhe persona të tjerë në veprime të kundraligjshme. I tillë është edhe rasti ku gjatë përgjimeve të të dyshuarit A.A. **D.Ll., F.Ll., rezulon se këta persona kryejnë ndërhyrje në veprimtarinë shtetërore të zyrtarëve, duke sjellur përmbushjen/mos të funksioneve në kushdërshtim më ligjin, kundrej veprimeve korruptive.**

Kështu gjatë hetimeve të kryera në funksion të kësaj çështje, me vendimet përkatëse të gjykatës, janë lejuar përgjime për numrat e telefonit celularë, konkretisht ndër të tjerë për numrin **xxx xx xx xxx**, në përdorim nga shtetasi D.Ll., për numrin e telefonit celularë **xxx xx xx xxx**, në përdorim nga shtetasi F.Ll., dhe për numrin e telefonit celularë **xxx xx xx xxx**, mbajtur në përdorim nga një person i paidentifikuar plotësisht i thirrur me emrin R.(punonjës IEVP), dhe numrave celular në përdorim nga A. A. .

Gjatë përgjimeve të numrave sa më sipër(por jo vetëm pasi janë mbajtur edhe raport vëzhgimet, janë sekuestruar më pas praktikat e transferimit etj), ka rezultuar se ka patur komunikime për kryerjen e veprimeve korruptive lidhur me transferimin e një të dënuari konkretisht të të dyshuarit O.K. nga një IEVP e sigurisë së lartë në Burrel në një IEVP tjetër (atë të Peqinit). Tratativat lidhur me transferimin e personave në IEVP, kanë vijuar edhe nga personat si brenda në sistem ashtu edhe jashtë tij.

Rezulton se O.K., i cili vuan dënimin në IEVP Burrel ka hyrë në kontakt me D.Ll. duke i kërkuar atij që nëpërmjet lidhjeve të tij të ndërhynte tek Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, e më pas ky i fundit të urdhëronte transferimin. Ky veprim do të bëhej kundrejt veprimeve korruptive.

I dyshuari D.Ll., ka arritur të kontaktojë me të dyshuarin **Q.M.**, në atë kohë si shoferi i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, të dyshuarit A.Ç., ku i është „propozuar“, transferimi i të dënuarit O.K. , kundrejt përfitimit të parregullt në para.

Ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se pasi i dyshuari D.Ll. është garantuar se nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, (garanci e marrë nëpërmjet shoferit të tij të dyshuarit Q.) është rënë dakort me të dënuarin O.K. se një veprim i tillë do të bëhej kundrejt një shumë prej 3000 euro.

I dënuari O.K. madje i ka premtuar D. edhe kalimin e një

automjeti. Pasi është rënë akordi për dhënien e kesaj shume dhe të automjetit, të dënuarit O.i është kërkuar që të bënte një kërkesë me shkrim për transferim. Kërkesa në fjalë i është dhënë të dyshuarit A.B. (edhe ky duke qenë se hyri si subjekt në këtë veprimtari u mbajt nën hetim me metoda speciale). Kërkesën më pas A.B. ja ka dërguar D.Ll., ku ky i fundit ja ka dhënë të dyshuarit Q.M. (i cili ishte si “urë lidhëse “ ndërmjet veprimeve të D. etj me Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve.

Pasi është siguruar shuma e parave prej 3000 eurosh nga lidhjet e O., ato më pas nëpërmjet të dyshuarit A.B. , i janë dhënë të dyshuarit D.Ll., po kështu është bërë edhe për një automjet. Para sa më sipër i janë dorëzuar më pas të dyshuarit Q.M., i cili ishte interlokutori me A.Ç. .

Ka rezultuar se transferimi i të dënuarit O.K. nuk ishte realizuar menjëherë, dhe ndërmjetëve ju është thënë se kjo ishte përshkak të procedurave, si dhe për faktin se O.K. , më parë në IEVP Peqin kishte qenë problematik. Duke i konsideruar si të panevojshme vonesat O.K. ka kërkuar kthimin e vlerave monetare, por Q.M. ka premtuar se transferimi do të ndodhte jo në IEVP Peqin por në IEVP Kruje ose Fushe Kruje.

Lidhur me këtë fakt nga ana e Drejtorit të IEVP Burrel është telefonuar DPB A.Ç. , duke i kërkuar se nëse do të bëhej transferimi i të dënuarit K. për të, ky i fundit i kërkon se të verifikonte pasi personat që i kishin ndërhyrë për të kishte dyshime mos i kishin bërë ndonjë pisllek, dhe se këtë fakt do ta verifikonte.

Ndërkohë që rezulton se ndërmjet të dyshuarve Q.M. , A.B. , D.Ll. dhe O.K. kanë vijuar komunikimet telefonike, dhe tratativat lidhur më këtë transferim. I gjendur në kushte të tilla D.Ll. kërkon ndihmë tek A.A. dhe F.Ll. në mënyrë që të ndërhyjnë tek i dyshuari A. që të realizohej transferimi, gjë që ka ndodhur, dhe transferimi është realizuar me date 09.07.2018. Kjo pasi

rezulton se Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve ka nxjerrë urdhërin me nr.7049 , datë 09.07.2018, për transferimin e shtetasit O.K. nga IEVP Burrel ne IEVP Fier. Ky transferim ka lanë të kënaqur të gjitha palët.

Nga sa më sipër ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se **A.Ç.** , ka kryer veprën penale "Korrupsioni pasiv i funksionareve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendore", parashikuar nga neni 260 i K.Penal.

Gjithashtu ka dyshime të arsyeshme se të dyshuarit **O.K., A.B., D.Ll. , Q.M.** , kanë kryer veprën penale "Korrupsioni aktiv i funksionareve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendore", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 245, 25 i K.Penal.

Siç është theksuar sa më sipër veprimtaria kriminale e grupit të

strukturuar kriminal ka një fillesë të hershme. Ajo i ka fillesat e saj tek vëllezërit A. , për të cilët kishte të dhëna për përfshirje në veprat penale të trafikimit të lëndëve narkotike ndërnacionale, por edhe prodhimit, shitjes dhe tregtimit të lëndëve narkotike në vend.

Lënda narkotike të llojeve të ndryshme pasi trafikohet nga vende të ndryshme, shpërndahet më pas nëpërmjet lidhjeve të tyre në tregun e brendshëm. **J. K.** alias "**Cine**", rezulton se është banor në Shijak. Ka përdorur gjeneralitetet **J. A.** . Përdor nr.tel.cel. **XXXXXXXXXXXX, XXXXXXXXXXXX, XXXXXXXXXXXX, XXXXXXXXXXXX** dhe **+XXXXXXXXXXXXXXXX**. **Gjatë kësaj kohe janë evidentuar një sërë përgjimesh telefonike, të J. K. jo vetëm me bashkëpunëtorët e tij të ngushte por edhe me pjestarë të grupeve të tjera, ku pjesa më e madhe e tyre rezulton ngë e njëjti vend Shijaku (ku evidentohen takime, biseda të përgjimeve dhe aktivitet në bashkëpunim edhe me A. A. apo edhe me H. S.).**

Nga hetimi kanë rezultuar të dhëna se shtetasit J.K., F.Ll., Sh.A. dhe D.Ll. gjatë aktivitetit të tyre të kundraligjshëm në fushën e narkotikëve ato kanë krijuar lidhje të forta me persona të tjerë edhe në qytetin e Tiranës, ku furnizohen me droga të llojeve të forta me qëllim shpërndarjen e tyre më pas. Rezulton se lëndën narkotike shtetasi J.K. e mban tek shtëpia e vëllezërve D. dhe K.Ll. , të cilët marrin përsipër edhe shpërndarjen e lëndës narkotike.

Nga hetimi kanë rezultuar të evidentohen pesë grupe kriminale, të cilët ndërveprojnë me njëri-tjetrin në kryerjen e veprave penale të ndryshme në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe kanë shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Nga hetimet e deritanishme rezulton se anëtarët e këtyre grupeve kriminale, përveç bashkëpunimit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, e kanë ushtruar aktivitetin kriminal në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike si kokainë, heroinë dhe cannabis sativa në disa vende të tjera si Turqi, Kolumbi, Mbretëria e Bashkuar, Gjermani, Norvegji, Hollandë, Itali dhe Kosovë.

Gjatë hetimeve për një kohë të gjatë si nëpërmjet përgjimeve telefonike ashtu edhe me metoda të tjera speciale kanë rezultuar të dhëna të shumta për përfshirjen e një numri të madh personash në këto grupe kriminale. Ndër të tjera rezulton se ka dyshime se në këto grupe si lidhje të disa personave nën hetim janë shtetasit; **A.L.(alias A.M.) Z.A., A.A., Zh.K., E.D., A.S., L.B., E.B., N.Gj., O.J., M.B., Sh.X., H.H., A.C.(alias E.), D.H.(alias F.), E.B., Sh.I., I.Sh., Sh.I., K.B., I.Y., A.K.**, bashkëpunojnë me grupet kriminale për të cilat po hetohet. Gjatë përgjimeve të kryera dhe vëzhgimeve në ambiente publike kanë rezultuar se ka dyshime se këta shtetas mbajnë lëndë narkotike (të cilën e marrin nga anëtarët e grupit kriminal) dhe sende të tjera të kundraligjshme si armë zjarri të cilat u perkasin veprave penale dhe personave për të cilat po hetohen.

Nga hetimi kanë rezultuar të evidentohen pesë grupe kriminale, të

cilët ndërveprojnë me njëri-tjetrin në kryerjen e veprave penale të ndryshme në kuadër të grupit të strukturuar kriminal dhe kanë shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Nga hetimet e deritanishme rezulton se anëtarët e këtyre grupeve kriminale, përveç bashkëpunimit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë e kanë ushtruar aktivitetin kriminal në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike si kokainë, heroinë dhe cannabis sativa në disa vende të tjera si Turqi, Kolumbi, Mbretëria e Bashkuar, Gjermani, Norvegji, Hollandë, Itali dhe Kosovë.

Gjithashtu nga hetimi rezulton se shtetasi A.H., mbajtës i numrit celular ~~XXXXXXXXXXXXXX~~, ka patur komunikime telefonike me shtetasin H.H. (sipas të dhënave rezulton të jetë djali i xhaxhait), dhe me pas ky i fundit me shtetasin S.Gj. . Bisedat telefonike të personave (ku siç është cituar sa më sipër S.Gj. është i dyshuar për kryerjen e disa veprave penale, por që edhe H.H. ka qenë subjekt i përfshirë në këtë procedim, ku veprimtaria e tij vijon të jetë në hetimet e organeve përkatëse) kanë qenë të tillë që jepnin të dhëna se këta shtetas bashkëpunojnë me anëtarët e tjerë të grupit kriminal për trafikimin e lëndëve narkotike.

Gjatë veprimeve hetimore të kryera ka rezultuar se shtetasi A.H. ka pritur dhe takuar dy shtetas Turq dhe një shtetas kosovar, dhe konkretisht shtetasit **I.S., N.C. alias L. L. dhe Xh.S. shtetas Kosovare**, tek hoteli i tij në Rinas, Tiranë dhe pas këtij takimi janë nisur me një furgon për në Kukës nga hoteli i tij në Rinas. Personat sa më sipër janë mbajtur nën vëzhgim dhe survejim, ku janë kordinuar veprimet edhe me OPGJ që po merreshin me hetimet në kuadër të grupit të strukturuar kriminal (disa syresh që lidhen me njëri-tjetrin nga interlokutorët e tyre) ku u arrit të dokumentohej veprimtaria e tyre kriminale në lëmin e narkotikëve, ndër të tjera të **A.H., S.Gj. si dhe shtetasit I.S., N.C. alias L.L. dhe Xh.S. shtetas Kosovare**.

Nga veprimet e kryera rezulton se shtetasi A.H. ka komunikuar dhe bashkërenduar me shtetasit I.S. , N.C. alias L.L. dhe Xh.S. shtetas Kosovare, të cilët kanë sjellë në Republikën e Shqipërisë lëndën e parë për prodhimin e heroinës dhe kokainës ndërkohë që shtetasi A.H. kishte përgatitur ambjentin dhe laboratorin për përpunimin dhe prodhimin e lëndës narkotike në bashkëpunim me persona të tjerë disa të arrestuar por edhe disa të pidentifikuar plotësisht deri më tani.

Me datë 18.10.2018, ora 16:40, (edhe pse në vijim të hetimeve në kuadrin e procedimit 339 të vitit 2016, por Drejtoritë vendore nuk janë vënë në dijeni mbi ekzistencën e këtij procedimi në mënyrë që të mos dekonspiroheshin hetimet e grupeve sa më sipër) nga Policia Gjyqësore janë informuar se në banesën e shtetasit M.Sh. (e ndodhur në fshatin Brenogë), kishte lëndë të kundraligjshme e dyshuar si narkotike, si dhe janë sinjalizuar mbi ekzistencën e një "laboratori" për përpunimin e saj.

Nga procesverbali i kqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 18.10.2018 (ndërsa automjetet janë kqyrur në vijim edhe me datë 19.10.2018), ndër të tjera ka rezultuar se: *gjate këqyrjes ne ambientet e jashtme te banesës se*

shtetasit M.Sh. , është konstatuar një automjet me targa xx xxxxx, "MITSUBISHI" në pronësi të shtetasit Xh.Sh. (automjet në të cilin nuk u gjet gjë me vlerë për hetimin). Ndërsa në anën veriore të këtij automjeti ndodhej një automjet tjetër i parkuar me targa xx xxxxx me ngjyrë të bardhë, tip BENZ 250, në pronësi të shtetasit B.H. . Nga kqyrja e këtij automjeti janë gjetur dhe sekuestruar një sasi qesesh të tejdukshme në forme zarfesh.

Po kështu në drejtim të oborrit të shtëpisë është gjetur një automjet i parkuar i **tipit VOLSËAGEN me targa xx xxxx xx**, ku në pjesën e pasme të furgonit ndodhej një kuti e mbushur me ngjitës natriban me ngjyrë kafe. Automjeti ka rezultuar të jetë në pronësi të firmës "PAPA RENT" lëshuar për përdorim shtetasit shqiptar F.S. . Nga përpunimi me pluhur daktiloskopik alumini janë përfutur 4 gjurmë papilare të vlefshme për identifikim. Pas këtij automjeti ndodhej një tjetër automjet i parkuar me targa **xx xxxxx, tip fugon BENZ**, i mbyllur në pronësi të shtetasit Sh.S. . Nga këqyrja në ambientet e brendshme të automjetit janë konstatuar thasë të hedhura në mënyrë të çrregullt 25kg të firmës "SIGECAM" me mbishkrimin "CARBONATIO DI SODIO", si dhe shishe me ngjyrë kafe, bidonë plastik të formave dhe përmasave të ndryshme.

Gjithashtu pas furgonit janë gjetur edhe 9 bidonë plastik të bardhë të formave dhe përmasave të ndryshme të mbushura me lëndë të lëngshme si dhe një bidon rreth 30 kg i mbështjellë me plasmasë me ngjyrë blu. Po kështu është gjetur një divan përballe shtëpisë, doreza plastike, maska sterile, furça boje etj. Ndërsa në një ambient të përshtatur si dhomë gatimi afër shtëpisë së shtetasit M.Sh. , janë gjetur 10 bidonë plastik të mbushura me lëndë të lëngshme me mbishkrimin 'ACID PISHIN', një valixhe udhëtimi në të cilën ndodheshin 14 pako të mbështjella me natriban në të cilën kishte lëndë me ngjyrë kafe e dyshuar si lëndë narkotike, një bombël gazi e shoqërisë "GAZ SHA" me një tub që përfundonte në një furnele gazi, një palë doreza të gomuara, një gotë qelqi.

Në vijim të kqyrjes ka rezultuar se pas kësaj dhome ndodhej një ambient në të cilin ndodheshin disa fuçi të mëdha plastike me ngjyrë kafe dhe një fuçi tjetër plastike me ngjyrë blu në të cilat kishte lëndë të lëngshme. Në këtë ambient është gjetur edhe një lëndë ngjitëse me ngjyrë të zezë. Nga ana e eksperteve kimist është sqaruar se pas ekzaminimeve në aparatit FTIR, rezultoi se në lëndët e gjetura në furgonin tip BENZ, me targa xx xxxxxx, rezultoi prezence e "anhidrik citrik", dhe një lëndë tjetër "DIETIL ETER".

Gjithashtu Policia Gjyqësore ka vijuar me kqyrjen e pjesës së banesës ku në ambientet e brendshme të saj është gjetur një sasi prej 161 pako të mbështjella me natriban në të cilën dyshohet se kishte lëndë narkotike. Gjatë këqyrjes së banesës janë gjetur edhe disa karta "Raiffeisen bank" të A.Sh. , kartë identiteti në emër të shtetasit A.Sh., kartë identiteti i shtetasit I.Sh., mastër kard Raiffeisen bank në emer të Xh.Sh., Kartë Raiffeisen bank, I.Sh., Kartë Visa në emër të H.Sh., pasaporte në emër të Xh.Sh., telefon i markes XIOMI, leje drejtimi, kartë identiteti, kartë banke në emër të shtetasit F.Ç. një palë celesa audi, Ipad, USB etj.

Gjatë këqyrjes janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale Automjeti tip BENZ me targa xx xxxxxx më ngjyrë të bardhë, Libreze për instrumentat

matëse xx xxxx x në emër të B.H. , Certifikatë pronësie për automjetin me targa xx xxxxxx në emër të B.H.H., leje qarkullimi për automjetin me targa xx xxxxxx në emër të B.H. , Automjet me targa xx xxxxxx, tip VOLSËAGEN, në pronësi të firmes PAPA RENT lëshuar për përdorim shtetasit shqiptar F.S., faturë shitje tatimore lëshuar nga E.L.për shtetasin Turk, K.O.O., Certifikatë e kontrollit teknik për automjetin me traga xx xxxxxxxx, Police sigurimi e mjetit targë xx xxxxxxxx, Leje qarkullimi për automjetin me targa xx xxxxxxxx, automjet me targa xx xxxxxx tip BENZ, në pronësi të shtetasit Sh.S., leje qarkullimi për automjetin me targa xx xxxxxxxx, çertifikatë e kontrollit teknik për automjetin me targa xx xxxxxxxx, policë sigurim për automjetin me targa xx xxxxxxxx, automjet me targa xx xxxxxxxx, në pronësi të shtetasit F.Ç., leje qarkullimi për automjetin me targa xx xxxxxxxx, çertifikate pronësie në emër të F.C., çertifikatë e kontrollit teknik, kontratë shitblerje në emër të F.Ç., qese transparente të madhësive të ndryshme në formë zarfa me permasa 25x30cm dhe 25x34cm, pesë bidone plastik me ngjyrë të tejdukshme 0.5L të gjetura në automjetin me targa xx xxxxxxxx, qese me farë me ngjyrë të zeze, 9(nëntë) bidona plastik të bardhë të formave dhe përmasave të ndryshme, bidon plastik i mbushur me lëndë të lëngshme, dy pale syze plastike, dy palë doreza trikotomi, kater palë furçe boje, tre cope shpatulla plastike, pesë maska sterile, një kuti me natriband, gur fresibel, kazan inoksi me mbishkrimin ARIAN, dhjetë bidona plastik me permasa 45x26x28cm, me mbishkrimi “ACID PISHIN” të mbushura me lëng ku njëri është i zbratur, një bidon plastik me 3L i mbushur me lëndë të lëngshme, ..., tre fuçi plastike me ngjyre kafe, një fuci me ngjyrë blu, **175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) pako me përmasa 20x8x8cm të mbështjella me natriban të mbushur me lëndë e dyshuar si narkotike në sasinë 182.5 kg**, lëndë e lëngshme sasinë 19.2 litra, lëndë ngjitëse në sasinë 1.56kg, tre valixhe që shërbenin për ambalazh të lëndës së dyshuar narkotike, dy pako me telefon me nga njëqind pjata plastike me ngjyrë të bardhë brenda, dy qese me telefon me nga njëqind luge plastike ..., dy peshore elektronike, arkë kartoni me mbishkrimin Belino, me 10 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë “dyhelyl ehter”, arkë kartoni me mbishkrimin Marmo, me 11 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë “dyhelyl ehter”, arkë kartoni me mbishkrimin Fritoloy, me 14 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë “dyhelyl ehter”, arkë kartoni me mbishkrimin ngjyrë e zezë me shkronja greke, me 10 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë “dyhelyl ehter”, arkë kartoni me mbishkrimin Crossant, me 11 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë “dyhelyl ether, arkë kartoni me mbishkrimin Deperibile, me 9 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë “dyhelyl ehter”, arkë kartoni me mbishkrimin Reply, me 16 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë “dyhelyl ehter”, arkë kartoni me mbishkrimin Belino, me 11 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë “dyhelyl ehter”, arkë kartoni me mbishkrimin Molto, me 10 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë “dyhelyl ehter”, arkë kartoni me mbishkrimin Reply, me 16 copë shishe, qelqi një litërshe, me ngjyrë kafe me etiketë “dyhelyl ehter”, arkë plastike me ngjyrë të zezë, si ajo e perimeve, e cila ka 12 copë shishe me etiketë “dyhelyl ehter”, 3 kuti kartoni, me ngjyrë kafe,me

numër 61435, ku janë 11 bidona plastikë, 2.5 litërsh me ngjyrë të bardhë, me etiketë aceton, dy kuti kartoni me etiketë Vër ku janë dhjetë copë shishe qelqi 2.5 litërsh me etiketë Hidroklerid acid, 14 copë bidona plastikë, më ngjyrë të bardhë, 2.5 litërsh seicili, me etiketë acid sulfurik 96 gradë, 11 copë bidona plastikë të bardhë 2.5 litërsh me etiketë hidroklerid acid, 98 copë bidona plastikë të bardhë, 1 litërsh, me etiketë “dyethylether”, 2 copë shishe qelqi 2.5 litërsh me etiketë “aceton”, 7 copë bidona plastikë 5 litërsh, me ngjyrë të bardhë, me etiketë “aceton”, si dhe objekte të tjera.

Të dhënat e përftuara deri më tani në rastin konkret tregojnë se lëndët dhe sendet materjale sekuestruar sa më lartë, në vendin e gjetur shërbenin për prodhimin e lëndëve narkotike si ajo e Heroinës.

Për këtë ngjarje janë arrestuar në flagrancë disa persona, ku veprimet i ka kryer Prokuroria e Rrethit Kukës, dhe kjo është bërë me qëllim që të mos dilnin të dhënat lidhur me personat e tjerë bashkëpunëtor të këtij grupi kriminal, ndërkohë që ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se të dyshuarit **Xh.Sh., N.C., I.S., A.H.H. H. në bashkëpunim ndërmjet tyre në formën e grupit të strukturuar kriminal kanë konsumuar veprat penale:** “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Trafikimi i narkotikëve”, “Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope”, në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuara nga nenet 283, 284/c, 283/a, 287, 333/a, 334 të Kodit Penal. Kjo pasi dyshohet se lënda e parë për prodhimin e Heroinës dhe Kokainës është trafikuar nga jashtë, ata kanë ngritur një minilaborator për prodhimin e lëndëve narkotike, janë gjetur dhe sekuestruar sasi të mëdha prekursorësh për përgatitje e lëndëve narkotike, e kryer kjo në formën e grupit të strukturuar kriminal.

Nga ana e Gjykatës së Krimeve të Rënda është caktuar masa e sigurimit për personat bashkëpunëtor sa më lartë ku disa nga këto masa sigurimi nuk janë ekzekutuar ende.

Nga kontrolli i ushtruar tek ambientet e banesës së shtetasit H.H., (sipas procesverbalit të datës 21.10.2018, ora 16:00) janë gjetur dhe sekuestruar një presë metalike (sipas procesverbalit përkatës me përmasa **20x10cm**, me kapakë dhe bazament të çmontueshëm) që shërben për paketimin e lëndës narkotike të llojit heroinë. Nga akti i ekspertimit kimik Nr.1339, datë 31.12.2018, ka rezultuar se në presën metalike objekt ekspertimi, analizat me GC/MS treguan praninë e heroinës.

Nga hetimet ka rezultuar se me datë 02.12.2018, në një banesë në Prishtinë Kosovë, janë gjetur dhe sekuestruar **një sasi prej 113.5 kg**, e dyshuar si e llojit heroinë ku janë arrestuar shtetasit **Xh.Sh., shtesi Turk I.S. dhe është gjetur i vdekur në banesë N.C.** . Ndërkohë që për këta persona nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë është lëshuar masa e sigurimit në mungesë për ngjarjen e lëndë së gjetur në Has, pra kjo lidhet me procedimin nr339/2016. Sipas akteve të dosjes nga ana e Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, me shkresën Nr.331 Prot, datë 24.12.2018, ju është kërkuar ndihmë juridike autoriteteve Gjyqësore të Kosovës lidhur me faktin sa më

sipër.

Pas përfutimit të të dhënave sa më sipër (pas marrjes së aktit të ekspertimit kimik për mbetjet e presës metalike është urdhëruar rregjistrimi i emrit të personit duke i atribuar njëserë veprash penale, dhe pas përfutimit të një sërë përgjimesh telefonike), nga ana e Prokurorisë me Urdhërin e datës **17.01.2019**, është urdhëruar ndalimi i personit nën hetim **H.H.** . Kjo ndër të tjera nga ana e OPGj të forcave të Posaçme Operacionale me informacionin e datës **17.01.2019, ora 12:35**, se pas marrjes së informacionit nga agjensitë ligjzbatuese kishte të dhëna se shtetasi **H.H.** do të largohet jashtë shtetit me qëllim për tu larguar dhe për ti shpëtuar ndjekjes penale.

Në kushtet sa më sipër, në zbatim të nenit 253 të K.Pr.Penale, kur personi nën hetim ishte i dyshuar për vepra penale që parashikojnë dënim më shumë se 4 vite dhe kur kishte rrezik ikje, Prokurori ka nxjerr urdhërin e ndalimit, urdhër i ekzekutuar me datë 18.01.2019, ora 17:30.

Nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë me vendimin Nr.11, datë 21.01.2019, ndër të tjera është vendosur: *1Vleftësimin si të ligjshëm të ndalimit të bërë nga Policia Gjyqësore, në datë 18.01.2019 ora 17:30, ndaj personit nën hetim H.H. . 2Caktimin si masë sigurimi personal me karakter shtrëngues "Arrest në burg", parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, ndaj personit nën hetim, H.N.H. , si i dyshuar për veprat penale të: "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Trafikimi i narkotikëve", "Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope" në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal", "Pastrimi i produkteve të veprës penale", të parashikuar nga nenet 283, 284/c, 283/a, 287, 333/a, 334 të K.Penal.*

Siç u citua edhe më sipër në ambjentet e banesës së personit nën hetim H.H. është gjetur dhe sekuestruar ndër të tjera një presë metalike që shërben për paketimin e lëndës narkotike të llojit heroinë që sipas aktit të ekspertimit ka rezultuar se në të ka mbetje të lëndëve me përmbajtje si ajo e heroinës.

Rezulton se si para ngjarjes ashtu edhe ditën e ngjarjes (datë 18.10.2018) personi nën hetim **H.H.** ka patur komunikime të vazhdueshme ndër ta me personat nën hetim **S.Gj. , A.H.** (ky i fundit sipas të dhënave është djali i xhaxhait të H.H.) etj që lidhet me faktin e ngritjes së "laboratorit" për prodhimin e lëndëve narkotike dhe prekursorëve, në bashkëpunim të veçantë edhe me persona të tjerë, të cilët tashmë janë me masë sigurimi, për disa të ekzekutuara dhe për disa akoma jo.

Nga aktet në dosje ndër të tjera rezulton se sipas Procesverbaleve "Mbi veprimet e vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve të datave **16.10.2018-18.10.2018**, janë mbajtur në mbikqyrje lëvizjet e personave nën hetim ndër ta edhe për **A.H.** .

Kështu me datë 16.10.2018, ora 09:43, rezulton se automjeti tip Audi **me targë xx xxx xx** i cili drejtohej nga **A.H.** , tek rreth rrotullimi

në afërsi të Aeroportit Nënë Tereza, ku pas tij qëndron automjeti tip **Volsëagen ngjyrë gri me targa xx xxxx xx**, i drejtuar nga një person i moshës 48 vjeç...të cilët në orën 09:45, parkohen tek kompleksi **ADOR RESORT**. Në orën 09:55, A.H. dhe personi tjetër kanë lëvizur me automjetin me tagë **xx xxx xx**, në drejtim të Kukësit, të cilët janë takuar edhe me persona të jerë.

Me datë 17.10.2018, është dokumentuar lëvizja e **A.H.**, ku nga **ADOR RESORT** lëviz me një tjetër person me automjetin tip Volsëagen ngjyrë gri me **targa xx xxx xx**, duke blerë mallra të ndryshme në zonën e Vorës dhe në afërsi të Tiranës, të cilët takohen me disa persona të tjerë, të cilët po atë ditë lëvizin në drejtim të Qetetit Kukës, ku pasi kanë takuar shtetasi **Xh.Sh.**, në orën 16:30, janë vendosur në fashtin **Brenogë**. Në orën 19:04, ata janë nisur përsëri për në Tiranë, ku janë akomoduar në **ADOR RESORT**.

Me datë 18.10.2018, ora 13:34 (ku janë nisur nga **ADOR RESORT**) janë konstatuar automjetet tip Volsëagen ngjyrë gri me targa **xx xxx xx** dhe tip Sprinter Mercedes Benz me targë **xx xxx xx**, duke lëvizur në drejtim të fshatit Brenogë, ku në orën 13:49, kanë mbërritur tek banesa e **Xh.M.Sh.**.

Me datë 18.10.2018, rreth orës 16:40, është bërë arrestimi i disa personave dhe sekuestrimi i lëndëve narkotike heroinë (**175 pako të mbështjella me natriban me një shirit jeshil me përmasa 20x8x8 cm, në total prej 182.5 kg, me lëndë pluhur ngjyrë bezhë**) dhe laboratorit për përpunimin e saj, ku u sekuestruan me sende të dyshuara edhe automjetet të cilat kishin qenë në **ADOR RESORT**, të përdoruara nga **A.H. dhe të dyshuarit e tjerë**.

Raport vëzhgimet dhe provat sa më sipër lidhen edhe me përgjimet telefonike ndër ta vlejné të përmenden përgjimet ndërmjet:

Numrit xxxxxxxxxxxx dhe xxxxxxxxxxxx (në përdorim të të dyshuarit A.) sipas të cilit personi sa më sipër i dërgon sms me përmbajtje: I thuaj se për një orë e pres tek vendi ku u takuam kur të jem aty do të shkruaj por qeset ti anullojë nëse nuk janë siç i kërkove...

Transkript mes numrit xxxxxxxxxxxx dhe numrit xxxxxxxxxxxx, (datë 16.10.2018) sms text: Po çdo e takosh ai më tha për nesër me taku.

Transkript mes numrit xxxxxxxxxxxx dhe numrit xxxxxxxxxxxx, (datë 16.10.2018) sms text: Nuk e paske lexuar mesazhin me duket e takova dhe e lamë që do ti sjell vetë në otogar tek alpari e takova krejt rastësisht në orën gjashtë e njëzet sa/ po të shkrova ty.

Transkript mes numrit xxxxxxxxxxxx dhe numrit xxxxxxxxxxxx (datë 16.10.2018); +111: nesër aaa, si kalove.. ka ora tetë e gjys mjesit ke lokali; +790: po re: +111: mundohu per nja dy tre ditë katër ditë maksimumi; +790: mirë mirë po marr plaqkat me vete pra, me çfarë të vij deri atje; +111; shif gjej noj makinë të rastit ndonjë furgon; +790: po mirë, po qe ashtu marr ndonjë shok të më bie deri atje; +111: ee me prit tu pi kafe atje, se unë jam me makinë te madhe, pranaj; +790: a është rruga e lirë andej nga Rrinsi, e kalu; +111; krejt lirë është, çpunë ke në vorë, deri tek lokali vjet ti; +111: po.

Transkript mes numrit xxxxxxxxxxxx dhe numrit xxxxxxxxxxxx, (datë 17.10.2018) sms text: po vij në Tiranë jam në Vlorë je për kafe.

Transkript mes numrit xxxxxxxxxxxx dhe numrit xxxxxxxxxxxx, (datë 17.10.2018 sms text: ok takojm pak te Ringu se du me lëviz.

Transkript mes numrit xxxxxxxxxxxx dhe numrit xxxxxxxxxxxx, (datë 17.10.2018, ora 13:40) sms text: Përshëndetje cu bë me atë djalin Z. e ke por

lidhu njëherë me atë djalin se nuk ka ardhur akoma autobuzi edhe pak është gati për tu nisur.

Transkript mes numrit xxxxxxxxxxxxxx dhe numrit xxxxxxxxxxxxxx, (datë 17.10.2018, ora 14:06) sms text: Ckemi si ja kalon kur po pim kafe/ S'jam andej jam larg.

Transkript mes numrit xxxxxxxxxxxxxx dhe numrit xxxxxxxxxxxxxx, datë 18.10.2018, ora 15:31: +111; a i largove krej dhe kasafortën/ +041: po po, +111: dërgoj tek të tjerat e di ajo ku janë të tjerat, +041: mirë.

Ndër të tjera nga transkriptimi i përgjimeve (pjesë e akteve të dosjes), komunikime ndërmjet numrit celular xxxxxxxxxxxxxx (i thirrur me pseudonimin R. , numër në përdorim të personit nën hetim H.H. djali i xhaxhait të A.H.) dhe xxxxxxxxxxxxxx në përdorim të të dyshuarit A.H. datë 30.08.2018, ndër të tjera rezulton:+333:Ka je/+111:Hiq...në Tiranë/+333 e qa do bëjmë do takojmë sot/+111:Po thanen e lamë me këtë shokun, tim se ka gjet ky ni ashtu aty n'Durrës, që merr vesh nga këto letrat/+333:Okej ...rregullojmë njëherë letrat...+333:Mirë ...shife vetë edhe ashtu, po me atë ke fol me të/+111:Jo mor burr skam fol u ba nja një javë ni javë u ba/...hajt se folim nga afër...

Komunikim ndërmjet numrit xxxxxxxxxxxxxx, me numrin +333 në përdorim të personit nën hetim, datë 14.08.2018:sms me tekst:O shok po më vjen dori përdit/..kam për ti dhonë 800...Komunikim ndërmjet numrit xxxxxxxxxxxxxx (në përdorim nga i dyshuari S.Gj.me numrin +333, datë 14.08.2018 sms :o shok në dark do shkoj te ai se nuk erdhi knej/hë shok a vonohesh/a ikim bashkë/I tha do vij të takoj e kemi lon në 9 e gjys për zotin/o shok ska ardh akoma... Komunikom me numrin xxxxxxxxxxxxxx datë 12.09.2018 sms :Jam në Kosovë vij vonë nga darka. Komunikim i +333 me numrin xxxxxxxxxxxxxx ku ky i fundit i dërgon sms: o r. më erdh dori ke puna osht dhy puna keq po sme dhe leket deri sonte neser i du gjyth me tha./e kam litarin nfyto shok a bane noj gjo per ate 500 pakten ti jap ate/Neser kismet shok/

Komunikim i +333 me numrin xxxxxxxxxxxxxx, ku ky i fundit i dërgon me datë 14.08.2018 sms:Te them une se munt te hiki ne lezh me ket shokun dhe kthehem direkt ne tirane po nuk hika hikim bashke. Komunikim i +333 me sms me numrin xxxxxxxxxxxxxx, datë 14.08.2018: amon mer shok te kishim maru pune se kam dal legen me ate e kam majt gjith ditën tel te fik/+333 i kthen sms:ke te drejt/e di er shok kam dal dhe une legen me ty/sa te vij te mar une/.

Ndërsa sipas transkriptimit të përgjimeve të datës 17.10.2018, ndërmjet numrave xxxxxxxxxxxxxx (në përdorim të A.H.) dhe numrit xxxxxxxxxxxxxx, (në kohën kur kishin ardhur shtetasit nga Turqia dhe shtetasi Kosovar cituar sa më sipër) ndër të tjera rezulton:+111:alo o flori si kalove nesë vijnë ca miq të mij aty thua ju të ulen në kafe .../+544:do vijnë ca miq tuj dhe do shkojnë tek kafja.../+111: thuja të ulen tek kafja...+544:A. erdhën këta tre shokët unë po ju flas anglisht por spo më kuptojnë +111:mi jep në telefon/+544:po (nga ana e OPGJ është lënë shënimi se personat flasin Turqisht me A.), ndërkohë që përgjimet konvergojnë me vëzhgimet ambjentale të cituara sa më sipër.

Nga ana e Prokurorëve në kërkesën drejtuar Gjykatës kanë theksuar se ambjentet e Bar Restorant Hotel Ador dyshohet se janë përdorur për aktivitet kriminal. Po kështu edhe automjeti në pronësi të tij.

Në seancën gjyqësore të datës 30.01.2019, nga ana e prokurorëve (përveç provave të tjera të depozituara sëbashku me kërkesën si vendimet e Gjykatës procesverbalet e kqyrjes së vendit të ngjarjes sekuestrimet, raport vazhdimet etj, për më tepër referoju procesverbalit të seancës gjyqësore) paraqitet ndër të tjera si povë shkresore edhe Shkresën Nr.532/1 Prot, datë 29.01.2019, që është kthim përgjigje i ZVRPP Krujë, lidhur me pasurinë Nr.32/24 (ku një pjesë të praktikës e ripërsëriti edhe me shkresën Nr.580/1, Prot, datë 31.01.2019, të depozituar në seancën e datës 01.02.2019).

Sipas praktikës përkatëse ndër të tjera rezulton se me shkresën Nr.1085, datë 11.12.2012, Këshilli i Qarkut Durrës, ka përcjellur për në ZRPP Krujë, praktikën lidhur me përfundimin e punimeve të obektit “Bar-Restorant, Hotel 1,2,3,4 kat +Podrum, në Rinas, Krujë më investitor A. H. . Bashkangjitur: Leja e Ndërtimit, Vendimi i KRRT, Leja e Përdorimit, Akti i Kolaudimit etj. Sipas Aktit të Kolaudimit ndër të tjera rezulton se objekti në fjalë është me fillim punimesh Maj 2011, përfundimi Qershor 2012, me sipërfaqe sheshi 3320 m2, sipërfaqe ndërtimi 638 m2, katër kat mbi tokë, një kat nën tokë, me vlerë faktike të punimeve 79.868.982 lekë. Sipas çertifikatës për vërtetim pronësie rezulton se pasuria me numër 32/24, volumi 5, fq.27, me sipërfaqe prej 3320 m2, lloji i pasurisë Arë, është në pronësi të shtetasit A.H. .

Gjithashtu nga ZRPP, është përcjellë edhe praktika që kjo pasuri është me barrë siguroese për llogari të BKT, sipas Kontratës Nr.1010 Rep, Nr.384 Kol, datë 29.03.2012, kjo për të siguruar kredin në shumën prej 20.000.000 lekë, të marrë sipas kredisë Nr.1009 Rep, Nr.383 Kol, datë 29.03.2012. Gjithashtu bashkangjitur akteve është edhe planimetria e objektit në fjalë.

Sipas Procesvernalit “Për Kqyrjen dhe marrjen e provës dokumentare”, të datës 29.01.2019, ndër të tjera rezulton se OPGJ, ka bërë kqyrjen në “booking”, duke përfutur të dhënat lidhur me Ador Resort Hotel, si dhe duke përfutur fotografitë që ndodhen në faqen përkatëse.

Nga kqyrja në sistemin TIMS vetëm për vitin 2010, shtetasi A.H. ka 24 dalje (dhe 24 dalje), këto nga Aeroporti Rinas, kryesisht udhetime drejt Turqisë Stamboll.

Referuar sistemit E-Gjoha ndër të tjera shtetasi A.H. rezulton të kishte patur tre automjete (dy nga to të transaksionuara së fundmi), dhe në kohën e paraqitjes së kërkesës ai dispononte vetëm automjetin tip Audi me targë **xx xxx xx, (ku siç u theksua sa më sipër ishte përdorur gjatë veprimtarisë dhe takimeve me të dyshuarit bashkëpunëtor të tij).**

Nga ana e Prokurorëve gjithashtu u theksua se H.H. (dhe bashkëpunëtor të tjerë të tij) të cilët janë të përfshirë më herët në trafikimin e lëndëve narkotike, kanë pastruar të ardhurat nga veprimtaria kriminale nëpërmjet investimit të bërë tek kushëri i tij A.H. . Lidhur me këtë fakt të parashtruar në kërkesë të cilit i qëndruan edhe në seancë, Prokurorët paraqiten edhe vendimin **Nr.10, datë 26.03.2010**, të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë, sipas të cilit është vendosur:

*Deklarimin fajtor të të pandehurit **H.H.** , për veprën penale të “Trafikimit të narkotikeve”, e kryer në bashkëpunim dhe më **shumë se njëherë**, e parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 14 (katërmëdhjetë) vjet burgim.*

*Deklarimin fajtor të të pandehurit **H.H.**, për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me një vit burgim.*

*Deklarimin fajtor të të pandehurit **H.H.** , për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të municionit luftarak”, e parashikuar nga neni 278/3 i Kodit penal dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim.*

*Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal për bashkimin e dënimeve, dënimin e të pandehurit **H.H.** me 14 (katërbëdhjetë) vjet burgim.*

*Në aplikim të nenit 406 dënimin përfundimisht të të pandehurit **H.H.** me 9 (nëntë) vjet e 4 (katër) muaj burgim.*

Nga përmbajtja e vendimit në fjalë rezulton se H.H. është përfshirë në disa episode ku janë sekuestruar sasi të mëdha heroine, në një shkëpunim edhe me persona të tjerë, ngjarje të ndodhura në shtetin Italian. Në bazë të vendimit sa më lartë rezulton i dënuar edhe bashkëpunëtori tjetër i ngushtë i tyre shtetasi S.Gj. , i dënuar për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve”, e kryer në bashkëpunim dhe më shumë se njëherë, e parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal, me 11 vite burgim dhe në bazë të nenit 406 të K.PrPenale, përfundimisht me 7 vite e 4 muaj).

B. Lidhur me kërkesën për sekuestro preventive rezulton se:

Siç u theksua në vendim sa më lart, ka dyshime se personi nën hetim **A.H.** është i përfshirë në aktivitet kriminal lidhur me narkotikët, aktivitet i hershëm por i dokumentuar gjatë vitit 2016-2018, ku janë trafikuar sasi të konsiderueshme të lëndëve narkotike të ndryshme (sipas episodeve të cituar sa më sipër, ku po vijojnë hetimet në bashkëpunim edhe me institucionet ndërkombëtare ndër to ato Italiane, të Kosovës por jo vetëm, si dhe personi nën hetim **H.H.** rezulton i përfshirë kohë më parë në këtë aktivitet në disa shtete), nga ky aktivitet si një fakt i njohur botërisht përftohen të ardhura të mëdha, aq më tepër në sasinë dhe llojin e lëndës të përfshirë edhe personi nën hetim.

Vlen të theksohet se në vitin 2010-2012, A.H. ka investuar një shumë të konsiderueshme parash, ku vetëm vlera e ndërtimit të objektit është rreth 80.000.000 (tetëdhjetë milion) lekë, pa u përfshirë këtu vlera e investimit në blerjen e pasurisë tokë arë në shumën, si dhe mobilimi i Bar Resort Hotel Ador(që vlera i investimit rritet me shumën të konsiderueshme), dhe se në atë kohë ai mori një kredi në shumën prej 20.000.000 (njëzet milion) lekë.

Pavarësisht se ai mori një kredi, ajo nuk mbulon as 1/5 e investimit (duke llogaritur investimin në total për vënien në funksion të resortit). Në kushtet kur nuk ka të dhëna për ushtrim të aktivitetit të ligjshëm e aq më tepër për shumën të tilla (mbi 60.000.000 lekë), në kushtet kur A.H. rezulton lidhur me H.H. , në kushtet kur në kohën kur u dokumentua veprimtaria kriminale (në vitin 2016-2018, me shumë mundësi bashkëpunimi në këtë veprimtari është më i hershëm por në këtë kohë kanë vijuar hetimet dhe dokumentimi i kësaj veprimtarie), ka dyshime të bazuara se në kohën e ndërtimit të Resortit sa më sipër A.H. ka qenë i përfshirë në pastrimin e produkteve të veprës penale (të ardhurat e investuara nga H.H. dhe të dyshuar të tjerë).

Në kushtet kur personi nën hetim **A.H.** (por edhe bashkëpunëtorët e tij, ndër ta djali i xhaxhait të tij H.H. , bashkëpunëtor i ngushtë i tij) është si i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Trafikimi i narkotikëve”, “Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope” në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, ”Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga nenet 283, 284/c, 283/a, 287, 333/a, 334 të K.Penal, ndaj tij dhe familjarëve të tij, janë kryer dhe po kryhen hetime pasurore pasi ka dyshime të bazuara në prova për pastrimin e produkteve të veprës penale dhe të veprimtarisë kriminale.

Në kuadër të hetimit pasuror (dhe hetimit në tërësi të procedimit penal sa më sipër), prokuroria i është drejtuar një sërë institucioneve shtetërore (por edhe atyre ndërkombëtare me letërporosi) ku deri më tani janë përfutur të dhëna dhe prova lidhur me përkatësinë e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme.

Me procesverbalin e datës 25.01.2019, nga ana e OPGJ është bërë kqyrje dhe marrje e provës dokumentare, konkretisht dokumentacione nga Ëeb Page e QKB, në lidhje me subjektin me emrin tregtar “ADOR”, me emrin e subjektit A.H. , me numër NUIS XXXXXXXXXXXXX, me fushë veprimtarie në Bar Restorant Hotel. Sipas ekstrakt historik i QKB, ndër të tjera rezulton se subjekti është në formë ligjore Person Fizik (shumë e dyshimtë edhe kjo formë ligjore e ushtrimit të aktivitetit në një investim të tillë). Po kështu sipas ekstraktit në fjalë aktiviteti i këtij subjekti nga data 02.10.2018, është me status pasiv. Sipas kërkesës për pezullim aktiviteti rezulton se kërkesën në fjalë e ka nënshkruar vetë shtetasi A.H. .

Por sipas Gjykatës ky fakt është i dyshimte pasi edhe në datat 16.10.2018, e në vijim gjatë kohës që mbahej nën vëzhgim nga FLOP, ndër të tjera rezulton se resorti dhe Hoteli funksiononte rregullsiht dhe A.H. vijonte me aktivitetin e tij, ndër të tjerë akomodoi edhe shtetasit Turq dhe atë Kosovar. Po kështu nga kqyrja në Booking që bëri OPGJ, edhe në kohën e paraqitjes së kërkesës në gjykim aktiviteti i këtij hoteli vijon normalisht.

Nga ekstrakti historik, sa më sipër nuk rezulton të jetë depozitur në QKB asnjë dokumentacion apo të dhëna rreth aktivitetit ekonomik (balance apo të dhëna të tjera, është mbajtur si person fizik ndërkohë që sipas procesverbalit të kqyrjes elektronike në booking, ku dalin imazht dhe të dhënat per Ador Resort, sipas praktikës së kolaudimit etj, rezulton për një investim me vlera të mëdha.

Duke qenë në kushte të mësipërme, gjykata çmon se ka dyshime të

arsyeshme të bazuara në prova se nga aktiviteti i paligjshëm lidhur me narkotikët (cituar sa më sipër) janë përftuara të ardhurat të cilat janë investuar në pasuri e konkretisht:

-Bar-Restorant, Hotel 1,2,3,4 kat +Podrum, në Rinas, Krujë, më “investitor” A.H. , me sipërfaqe sheshi 3320 m², sipërfaqe ndërtimi 638 m², katër kat mbi tokë, një kat nën tokë, me sipërfaqe podrumi 630 m², kati përdhe 550m², kati i dytë 180m², kati i tretë 30m², me vlerë faktike të punimeve 79.868.982 lekë (për ndërtimin e godinës), e ndodhur mbi pasurinë me numër 32/24, volumi 5, fq.27;- automjeti tip Audi, me targë **XX XXX XX**.

Nisur nga sa më sipër, duke qënë se procedohet për veprat penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Trafikimi i narkotikëve”, “Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope” në bashkëpunim në formën e posacme të grupit të strukturuar kriminal, ”Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, të parashikuar nga nenet 283, 284/c, 283/a, 287, 333/a, 334 të K.Penal”, nga ana e organit të akuzës është kërkuar që bazuar në nenin 274 të K.Pr.Penale, të vendoset sekuestro preventive mbi disa pasuri (si ato në objektin e kërimit).

Kjo pasi dyshohet se ato janë produkt i veprave penale sipas parashikimit të nenit 36/1 të K.Penal, e lidhur me veprat penale të parashikuar nga neni 287, dhe dyshohet se lidhen me veprat penale për të cilën po hetohet ky procedim, ku ka dyshime të bazuara se disponimi i lirë i tyre mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e veprës penale.

~. Ligji i aplikueshëm në rastin konkret:

Në nenin 274 i Kodit të Procedurës Penale parashikohet shprehimisht se: “1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal...”.

Në nenin 276 i Kodit të Procedurës Penale sanksionohet: “1. Kundër vendimit për vënien ose mosvënien e sekuestrorit cilido që ka interes mund të bëjë ankim. 2. Kërkesa e ankimit paraqitet brenda dhjetë ditëve nga dhënia e vendimit ose nga dita që i interesuari ka marrë dijeni për sekuestron e vënë...”.

Neni 36 i Kodit Penal përcakton se: “1. Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit:...b) të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;”.

C. Vlerësimi i Gjykatës lidhur me kërkesën objekt gjykimi:

K.Pr.Penale, në lidhje me një procedim penal ka parashikuar se përveç masave të sigurimit personal të personit të atyre lidhur me lirinë personale, mund të vendosen edhe masat e sigurimit pasuror (Kreu VI), kur plotësohen parashikimet ligjore dhe kur mund të preket apo çënohet funksionimi dhe mbarëvajtja e procedimit penal. Kjo pasi disponimi i lirë i tyre mund të rëndojë, apo të zgjasë pasojat e veprës penale, ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera.

Në kreun përkatës janë parashikuar dy mjete të sigurimit pasuror sekuestro konservative dhe sekuestro preventive. Këto dy mjete vendosen për kushte të ndryshme, janë të pavaruar nga njëra tjetra (kanë parashikime të ndryshme ligjore dhe mund të vendosen në mënyrë të pavarur sipas kushteve përkatëse). Në kushtet e mjetit të dytë, pra të sekuestros preventive, me vendimin përkatës, autoriteti gjyqësor synon heqjen/bllokimin e një sendi/apo pasurie të përcaktuar, nga disponimi i lirë i një subjekti që e zotëron atë, duke i vendosur sendit një detyrim të caktuar, i cili mund të jetë me karakter të përkohshëm (apo përfundimtar në rastin e veprimtarive të ndaluara me ligj).

Lidhur me përcaktimet ligjore sa më sipër në zbatim të nenit 274 e vijues kërkohet:

I: dyshim/provë e veprës penale edhe më e lehtë se ajo e sekuestros konservative, madje pavarësisht nga fajësia apo njohja e autorit të saj. Për qëllim të caktimit të masës së sigurimit pasuror sekuestro preventive nuk është kusht njohja apo dyshimi në personin që i atribuohet vepra penale dhe përkatësia e pronësisë së sendit. Pra e thënë më thjeshtë, objekt i sekuestros preventive mund të jetë si sendi që i përket personit nën hetim (apo atij që i atribuohet vepra) ashtu edhe sendet që ju përkasin personave të tretë apo të dëmtuarve nga vepra penale.

Por në rastin në gjykim, Gjykata çmon se ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për kryerjen e disa veprave penale ndër ta nga personi nën hetim A.H. , për arsye se:

Gjatë shqyrtimit të kërkesës objekt gjykimi mbi bazën e provave dhe akteve bashkangjitur saj, rezultoi se është rregjistruar një procedim penal (cituar shprehimisht tek pjesa hyrëse), për vepra penale konkrete. Për personin nën hetim **A.H.** është lëshuar masë siguri e pa ekzekutuar deri më tani sipas vendimit Nr.157, datë 21.10.2018, për kryerjen e veprave penale: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Trafikimi i narkotikëve”, “Prodhimi dhe fabrikimi i lendeve narkotike dhe psikotrope”, në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuara nga nenet 283, 284/c, 283/a, 287, 333/a, 334 të Kodit Penal.

Në vitin 2010-2012, në kohën e investimit të objektit personi në fjalë nuk rezultoi të ketë patur të ardhura të ligjshme për të justifikuar pasjen e pasurive objekt sekuestrimi, me përjashtim të shumës prej 20.000.000 lekësh që përfshirë investimin total përbën më pak se 1/5 e investimit. Po

kështu ka dyshime se ai ka pastruar të ardhurat nga veprimtaria kriminale të bashkëpunëtorit (njëkohëshit djali i xhaxhait të tij) H.H. dhe të dyshuarve të tjerë, (S.Gj.). Pavarësisht kryerjes së veprës penale jashtë territorit të shqipërisë neni 6 i K.Penal parashikon se shtetasi shqiptar që kryen veprë penale jashtë territorit shqiptar mban përgjegjësi penale, dhe se ka dyshime se pastrimi i produkteve të veprës penale ka ndodhur në territorin Shqiptar.

Vlen të theksohet se ambjentet e Resortit u përdorën nga i dyshuari për takimet me bashkëpunëtorët e tij, ndër ta shtetasit Turq dhe atë Kosovar, si dhe ka dyshime se automjetet e përdorura nga ai dhe bashkëpunëtorët e tij, u përdorën për transportimin e lëndës narkotike (lënda e parë për prodhimin e heroinës që ishte Ham).

Në rastin konkret, ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova, se personi nën hetim ka kryer disa vepra penale. Gjykata çmon se nga aktet e administruara gjatë kësaj kërkesë krijohet dyshimi i arsyeshëm se personi ndaj të cilit kanë filluar hetimet, ka konsumuar elemente të veprave penale të: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Trafikimi i narkotikëve”, “Prodhimi dhe fabrikimi i lendeve narkotike dhe psikotrope”, në bashkëpunim në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuara nga nenet 283, 284/c, 283/a, 287, 333/a, 334 të Kodit Penal, **(duhet theksuar se hetimet janë në vijim por që për nuk kushtëzojnë kërkesën objekt gjykimi).**

Pasja e pasurive sa më sipër, përfshirja në veprimtari kriminale duke sjellur të ardhura me vlera të mëdha, veprimtaria kriminale dhe përfitimet e nxierra prej saj, bëjnë që të plotësohen parashikimet ligjore mbi sekuestron preventive.

II: Por kusht për vendosjen e sekuestron preventive është edhe prania e elementit të rrezikut apo dëmit nga vonesa. Në vetvete ky kusht përbën edhe qëllimin e nevojshëm për caktimin e kësaj mase sigurimi pasuror. Dhe kjo ka të bëjë me shmangien e ardhjes ose zgjatjes së pasojave nga vepra penale apo të lehtësimit të kryerjes së veprave të tjera penale. Rreziku për disponimin e lirë të sendit/pasurisë që mund të bëhet shkak rëndues, zgjatës, për veprën penale, apo shkak lehtësues për vepra të tjera penale duhet të jetë i një kriteri objektiv.

Përbëjnë objekt të sekuestron preventive, sipas pikës “1” të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, “sendet/pasurite që lidhen me veprën penale”, domethënë nga “marrëdhënia” e krijuar midis sendit dhe veprës penale të kryer, apo me të ardhurat që vijnë si rezultat i kryerjes së veprës penale, po të vazhdojë mbajtja e mëtejshme e sendit. Pra duhet të ekzistojë në këtë rast një lidhje e sendit me veprën penale dhe objektivisht mundësisë së zgjatjes apo rëndimit të pasojave të veprës penale/apo të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera.

Por sekuestro preventive si masë sigurimi pasurore mund të vendoset edhe për sendet produkt të veprës penale dhe çdo pasurie tjetër që lejohet të

konfiskohet sipas parashikimeve të nenit 36 të K.Penal (kjo në eventualitetin e pikës 2 të nenit 274 të K.Pr.Penale).

Në këtë rast objekti i sekuestros preventive përbëhet nga sendet/pasuritë e sekuestrueshme, sipas parashikimeve të nenit 36 të Kodit Penal: si sendi/pasuria duhet të ketë qenë ai që ka shërbyer apo ai i destinuar për kryerjen e veprës penale, apo përbën produktin e veprës penale, shpërblimeve, të dhëna, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i së cilit, përbën veprën penale dhe është e nevojshme vërtetimi i një lidhjeje të posaçme, funksionale (domethënë të qëndrueshme) midis sendit dhe veprimtari penal të kundërligjshëm.

Nga aktet dhe provat e paraqitura nga prokurori, cituar sa më lartë (të dhënave të tjera dhe provave ku për tepër referoju akteve të depozituara së bashku me kërkesën dhe ato të paraqitura në seancat gjyqësore nga ana e prokurorëve dhe të administruara në procesverbalin e seancës gjyqësore), rezulton dyshimi i arsyeshëm se pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të cituara në kërkesë objekt gjykimi, dyshohet se janë produkt i veprave penale të veprimtarisë kriminale cituar sa më lartë të ardhurat nga veprimtaria kriminale janë investuar në pasuri, **në Resortin janë “lidhur marrëveshje, ka shërbyer për akomodimin e personave të cilët u përfshinë në veprimtarinë kriminale, automjetet që transportuan lëndën e dyshuar qëndruan në ato ambiente, ka shërbyer si bazë më pas për aktivitetin kriminal të personit nën hetim A.H. dhe bashkëpunëtorët e tij”, dyshohet se ai pastroi produktet e veprës penale të personit nën hetim H.H. dhe të tjerëve (siç mund të jetë S.Gj.)** dhe në parashikimet e nenit 287 të K.Penal, dhe ka dyshime të bazuara në prova se janë investuar produktet e veprës penale, në kuptim të nenit 36/1/b të Kodit Penal.

Në rastin konkret gjykata çmon se produktet e veprës penale janë të tilla që mbartin lidhjen e drejtpërdrejtë dhe rrezikshmërinë e rëndimit të pasojave të veprës penale. Por ekziston dhe rreziku real se duke qenë të lira këto prona/pasuri/automjet subjekti do t'ia nënshtrojë veprimeve juridike (tjetërsimit të tyre tek te tretët, duke parë dinamikën e deri tanishme, madje tjetërsim i automjeteve në kohën kur subjekti ishte i dyshura për përfshirje në këtë veprimtari), ku duke qenë produkt i veprës penale dhe duke ju nënshtruar ato (edhe pse mund të kalojnë tek të tretët në mirbesim kur një send është produkt i veprës penale do të nënshtrohej konfiskimit) duke pas sjellë kështu cënimin e interesave të individit ashtu edhe ato shtetërore, dhe për rrjedhim rëndimin e pasojave të veprës penale.

Vlen të theksohet se sekuestro preventive në kuadër të nenit 274 e vijues të K.Pr.Penale, në lidhje me nenet 287 dhe 36 të kodit Penal, vendosen jo vetëm ndaj pasurive të personit nën hetim, por edhe ndaj atij që i atribuohet vepra penale, ndaj të tretëve (të afërt ose jo) **madje edhe ndaj viktimës së veprës penale**. Kjo pasi lidhet me kushtet e sqaruara sa më lartë, sekuestro ndjek “fatin” e pasurisë pavarësisht kush e posedon/disponon/ gëzon atë.

Lidhur me faktin se pasuria e paluajtshme objekt sekuestro

preventive të cituar sa më lartë është si barrë siguruese e vënë nga BKT, lidhur me kredinë e marrë në shumën prej 20.000.000 (njëzet milion) lekë, gjykata çmon se sekuestro preventive nuk çënon të drejtat e Bankës për të vijuar sipas parashikimeve **Procedurjalo-Civile**, që të nxierrë si kolateralin e saj ashtu edhe interesat apo penalitetet që ka në këtë rast, por vetëm për pjesën që i takon. Kjo duke u nisur nga vlera e kredisë dhe investimit (nuk mund të tjetërsojë të gjithë sendin ndërkohë që kredia mbulon një pjesë të saj).

Gjithashtu vlen të theksohet se sekuestro preventive është “ngurtësimi”, i kësaj pasurie deri në hetimin e plotë të rastit. Prokuroria ka detyrimin ligjor që pa vonëse të hetojë se: **si u përftuan të ardhurat për blerjen e pasurisë tokë arë me sipërfaqe prej 3320 m², në një zonë në afërsi të Aeroportit (dihet se çmimet për m², janë të lartë), në vitin 2010, si u përftuan shuma prej rreth 60.000.000 lekë, e investimit në ndërtimin e godinës, si u përftuan të ardhurat për mobilimin e këtij Resorti etj, si dhe të verifikojë nëse është në kushtet e ligjit 10192/2009, i ndryshuar. Në mënyrë që të mos çënohen interesat e të tretëve ku përshihet edhe Banka që ka dhënë kredinë.**

Për sa më sipër, gjykata vlerëson se plotësohen të gjitha kushtet e parashikuara në ligj për vendosjen e sekuestros preventive.

ZRPP, ka detyrimin që në zbatim të këtij vendimi të mos lejojë të kryhen transaksione, në bashkëpunim edhe me organet e tjera përkatëse. Gjithashtu për personin Fizik **“A.H.”, me emërtimin tregtar “ADOR”, QKB dhe organet përkatëse duhet të marrin masa që të ndalojnë tjetërsimin e aseteve të këtij subjekti (duke bërë shënimet në rregjistrat përkatës) deri sa ky vendim është në fuqi. Po kështu duhet të zbatojnë vendimin gjyqësor edhe DRTSh lidhur me automjetin përkatës.**

Duke qënë se sekuestro preventive vendoset mbi pasuritë që lidhet me veprën penale, masë e cila është paraprake (pra jo përfundimtare siç do të ishte konfiskimi i tyre dhe kalimi në favor të shtetit), duke sjellë kështu kufizim në të drejtën e tij të pronës, të garantuar nga neni 41/1 i Kushtetutës dhe neni 1 Prot I i KEDNJ, referuar edhe jurisprudencës së GJEDNJ, masa e sekuestros preventive në këtë rast parashikohet në ligj dhe synon vetëm ndalimin e disponimit të lirë të kësaj pasurie me qëllim mosrëndimin e pasojave të veprës penale, duke plotësuar kështu kriteret e kufizimit të së drejtës së pronës të përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në nenet 274, dhe 276 të Kodit të Proçedurës Penale, nenin 36 të Kodit Penal dhe nenet, nenin 1 Prot I të KEDNJ,

VENDOSI :

I. Pranimin e kërkesës.

II. Vendosjen e sekuestros preventive mbi pasurinë e paluajtshme:

1. **Bar-Restorant, Hotel "ADOR"** 1,2,3,4 kat +Podrum, në Rinas, Krujë, më "investitor" A.H. , me sipërfaqe sheshi 3320 m², sipërfaqe ndërtimi 638 m², katër kat mbi tokë, një kat nën tokë, me sipërfaqe podrumi 630 m², kati përdhe 550 m², kati i dytë 180m², kati i tretë 30m², i ndodhur mbi pasurinë me numër 32/24.

1. Automjeti tip Audi, me targë **XX XXX XX**, në pronësi të shtetasit **A.H. .**

IV. Urdhërohet Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë që të ndalojë shitjen, dhurimin, shkëmbimin apo çdo lloj disponimi tjetër të pasurisë së paluajtshme të cituar sa më sipër.

V. Urdhërohet Qendra Kombëtare e Biznesit që të **ndalojnë tjetërsimin e aseteve të personit Fizik "A.H.", me emërtimin tregtar "ADOR", dhe DRTSh lidhur me automjetin përkatës që të zbatojnë këtë vendim.**

VI.Për ekzekutimin e masës së sekuestros preventive të ngarkohet O.P.Gj Ilir Dorda dhe Atnan Shehu, pranë Drejtorisë së Policisë së Shtetit Tiranë.

VII.Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Për Krime të Rënda Tiranë, nga secili person që ka interes brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dhënia e vendimit ose nga dita që i interesuari ka marrë dijeni për sekuestron e vënë.

U shpall në Tiranë, sot me datë **01.02.2019.**

SEKRETARE
Alma STAJAJ

GJYQTAR
Bib NDRECA

